



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Fakulteti i gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit

Programi: Menaxhim dhe udhëheqje në arsim

PUNIMI MASTER

**Tema: "Ndikimi varësisë nga aparatet digjitale në
perfomancën akademike të nxënësve"**

Mentori:

Prof. Dr. Arafat SHABANI

Kandidatja:

Emine Abazi

Tetovë, 2021

DEKLARATË E AUTORËSISË

Deklaroj se punimin që e kam dorëzuar për vlerësim tek mentori, e kam shkruar në mënyrë të pavarur dhe se ai është tërësisht punimi im autorial. Gjithashtu, deklaroj se punimi në fjalë nuk është i publikuar e as i përdorur për qëllime të kryerjes së obligimeve mësimore, në këtë apo ndonjë institucion tjetër të shkollimit, dhe se në bazë të tij nuk kam fituar kreditë ECTS.

Më tutje, deklaroj se për nënshkrimin e punimit, kam respektuar rregullat etike të punës shkencore dhe akademike të Universitetit të Evropës Juglindore.

Emine Abazi

Në Tetovë, më _____

FALEMINDERIM

Rëndësinë e njerëzve përreth, e kuptojmë atëherë kur ata gjenden pranë nesh, sa herë që kemi nevojë. Prandaj, dua të shpreh falënderimet e mia për mbështetjen dhe dashurinë e pafund të familjes sime. Pa ndihmën dhe mbështetjen e tyre, s'do të isha këtu ku jam, për këtë u jam shumë mirënjohëse që më qëndruan pranë gjatë këtij rrugëtimi, me besimin e plotë që ata kishin te unë, prandaj ky punim është dedikim për ta. Falënderoj mentorin prof. Arafat Shabanin, që me punën dhe përkushtimin akademik, e bëri shumë më të lehtë këtë punim. Mirënjohje dhe falënderim shkon për të gjithë profesorët e Universitetit. Në saje të profesionalizmit të tyre dhe përkushtimit.

ABSTRAKT

Ky studim synon të vlerësojë ndikimin e varësisë nga aparatet digjitale dhe performancës akademike të nxënësve. Varësia zakonisht i referohet sjelljes së detyruar që çon në pasoja negative. Në shumicën e rasteve, njerëzit ndihen të detyruar të kryejnë aktivitete të caktuara aq shpesh, saqë bëhen një zakon i keq, i cili më pas ndërhyr në aktivitete të tjera të rëndësishme, të tilla si puna ose shkolla. Teknologjia e informacionit sot është zhvilluar me hapa shumë të shpejta dhe jo më kot sepse është nevojë e shoqërisë. Por duke qenë e tillë ajo mbart dhe probleme sepse përdoret më shumë seç duhet, kthehet në rrezik të madh ose serioz, për nxënësit.

Qëllimi ynë kryesor është të analizojmë ndikimin e varësisë nga aparatet digjitale dhe performancës akademike të nxënësve. Për ta analizuar varësin nga aparatet digjitale dhe performancës akademike tek nxënësit, në këtë studim anketuam 200 nxënës nga qyteti i Prishtinës të cilët ishin nga mosha 15 deri 18 vjet.

Rëndësia e studimit qëndron në faktin se rezultatet e studimit tregojnë në mënyrë të hollësishme rrjedhjen e varësisë nga aparatet digjitale dhe ndikimin e saj në performancën akademike të nxënësve, si dhe mund të krahasohen me studime të tjera të ngjashme në periudha të ndryshme kohore.

Për metodologjinë e këtij studimi është përdorur integrimi i metodave sasiore. Në këtë studim kemi përdorur dy instrumente, ku njëri instrument matën varshmërinë nga teknologjitë digjitale, kurse tjetri matën devijimet psiko-sociale tek nxënësit.

Rezultatet pritet të tregojnë se ka lidhshmëri shumë të dobët pozitive në mes varshmërisë nga teknologjitë digjitale dhe performancës akademike tek nxënësit, por që kjo lidhje nuk është sinjifikative. Po ashtu, rezultatet pritet të tregojnë diferencat gjinore në kontekst të varësisë nga teknologjitë digjitale dhe performancës akademike, por që këto dallime nuk janë sinjifikative. Në fund, mund të pohohet se gjetjet e këtij studimi mund t'i ndihmojnë nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit, që të kenë sa më të lehtë të kuptojnë varshmërinë nga teknologjitë digjitale dhe devijimeve psiko-sociale tek nxënësit. Po ashtu, prindërit dhe mësimdhënësit do të pasurohen me njohuri se si t'u ndihmohet nxënësve rreth varshmërisë nga teknologjitë digjitale.

Fjalët kyçe: Varshmëri, teknologji digjitale, nxënës, performancë akademike.

ABSTRACT

This study aims to assess the impact of digital device dependence and students' academic performance. Addiction usually refers to coercive behavior that leads to negative consequences. In most cases, people feel compelled to perform certain activities so often that they become a bad habit, which then interferes with other important activities, such as work or school. Information technology today has developed at a very fast pace and not in vain because it is a need of society. But as such it also carries problems because it is used too much, it turns into a big or serious risk for the students.

Our main goal is to analyze the impact of addiction on digital devices and students' academic performance. To analyze the dependence on digital cameras and academic performance in students in this study we surveyed 200 students from the city of Prishtina who were aged 15 to 18 years.

The importance of the study lies in the fact that the results of the study show in detail the flow of dependence on digital cameras and its impact on student academic performance and can be compared with other similar studies in different time periods.

The integration of quantitative methods was used for the methodology of this study. In this study we used two instruments where one instrument measures dependence on digital technologies, while the other measures psycho-social deviations in students.

The results are expected to show that there is very weak positive correlation between dependence on digital technologies and academic performance in students, but that this correlation is not significant. The results are also expected to show gender differences in the context of dependence on digital technologies and academic performance but that these differences are not significant.

Finally, it can be argued that the findings of this study can help students, parents and teachers to more easily understand the dependence on digital technologies and psychosocial deviations in students. Parents and teachers will also be enriched with knowledge on how to help students with their addiction to digital technologies.

Keywords: Addiction, digital technology, students, academic performance.

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE.....	9
I. KORNIZA TEORIKE.....	10
1.1 Varshmëria nga teknologjitë digjitale.....	10
1.2 Arsimimi dhe shoqëria digjitale.....	12
1.3 Lidhja e varshmërisë nga teknologjitë digjitale me performancën akademike në shkollë të nxënësve.....	13
1.4 Varshmëria nga teknologjitë digjitale dhe emocionet e fëmijëve.....	14
1.5 Lidhja midis varshmërisë nga teknologjitë digjitale dhe gjinisë.....	15
1.5.1 Lidhja midis varshmërisë nga teknologjitë digjitale dhe pasojave psiko-sociale	15
1.5.2. Lidhja midis varshmërisë nga teknologjitë digjitale dhe depresionit.....	16
1.5.3 Lidhja midis varshmërisë nga interneti dhe vetmisë.....	17
1.5.4 Lidhja në mes varshmërisë nga interneti dhe ankthit shoqëror.....	18
1.5.5 Lidhja mes varshmërisë nga interneti dhe vetëvlerësimit.....	18
1.5.6 Lidhja midis varshmërisë nga interneti dhe kënaqësisë nga jeta	19
1.5.7 Lidhja midis varshmërisë nga interneti dhe mbështetjes sociale	19
1.5.8 Lidhja mes varshmërisë nga teknologjitë digjitale dhe pasojave të tjera.....	20
1.6 Simptomat që tregojnë varshmërinë nga interneti.....	21
1.6.1 Simptomat emocionale të varshmërisë në internet.....	21
1.6.2 Simptomat fizike të varshmërisë nga interneti.....	22
1.6.3 Shenjat e sjelljes së varshmërisë nga interneti:	22
1.7 Varshmëria nga interneti dhe lojërat online.....	23
1.8 Lidhja në mes varësisë nga interneti dhe performancës akademike në kontekstin shqiptar...23	
II. METODOLOGJIA.....	25
2.1. Problemi i hulumtimit.....	25
2.2 Qëllimet e kërkimit, tezës.....	26
2. 3. Lënda e kërkimit.....	26

2.4. Hipotezat dhe qëndrimet hipotetike	27
2.5. Metodat dhe teknikat e kërkimit	27
2.6. Instrumentet e përdorura	28
2.7. Popullacioni dhe mostra.....	29
2.8 Qëndrueshmëria dhe vlefshmëria e pyetësorëve.....	31
2.8.1 Organizmi dhe rrjedhja e studimit	31
2.8.2 Përpunimi i statistikave.....	32
2.8.3 Struktura e punimit të tezës, kaptinat, pjesa teorike, elementet empirike.....	32
2.8.4 Kufizimet e studimit	33
2.8.5 Konsiderata etike e studimit.....	33
III. REZULTATET E STUDIMIT.....	35
3.1. Rezultatet lidhur me shpërndarjen e variablave	35
3.2. Rezultatet lidhur me korrelacionet.....	35
IV. DISKTUIMI I REZULTATEVE.....	44
PËRFUNDIME	50
SHTOJCA.....	52
REFERENCAT	59

Lista e tabelave

Tabela 1. Koeficientët e besueshmërisë për testimin e varësisë nga teknologjitë digjitale.....	24
Tabela 2. Koeficientët e besueshmëris për testimin e performances akademike tek nxënësit.....	25
Tabela 3. Paraqitja tabelare e shkollave në të cilat kemi marrë nxënësit si mostër për studim.....	25
Tabela 4. Paraqitja tabelare e gjinisë së nxënësve të përfshirë në studim, si dhe përqindja relative e tyre	26
Tabela 5. Paraqitja tabelare e moshës së adoleshentëve të përfshirë në studim	26
Tabela 6. Mesatarja dhe devijimi standard i nivelit të përgjithshëm të variablave.....	30
Tabela 7. Korrelacioni në mes varshmërive nga teknologjit digjitale dhe performancës akademike tek nxënësit	31
Tabela 8. Korrelacioni në mes varshmërive nga teknologjit digjitale dhe kohës së kaluar në aparatet digjitale	32
Tabela 9. Korrelacioni në mes varshmërisë nga teknologjitë digjitale dhe gjinisë së nxënësve.....	33
Tabela 10. Korrelacioni në mes varshmëris nga teknologjitë digjitale dhe moshës së nxënësve	33
Tabela 11. Korrelacioni në mes varshmëris nga teknologjitë digjitale dhe vendënaimit të nxënësve.....	34
Tabela 12. Korrelacioni në mes performancës akademikedhe gjinisë së nxënësve.....	34
Tabela 13. Korrelacioni në mes performancës akademikedhe moshës së nxënësve.....	35
Tabela 14. Korrelacioni në mes performancës akademikedhe vendbanimit të nxënësve	35
Tabela 15. Paraqitja tabelore e dallimeve gjinore në kontekst të varësisë nga teknologjitë digjitale	36
Tabela 16. Paraqitja tabelore e dallimeve gjinore në kontekst të performancës akademike.....	37

HYRJJE

Në këtë studim do të flasim për varësinë e nxënësve nga aparatet digjitale, si dhe ndikimin e tyre në performancën akademike. Shumë prej nesh e dinë atë ndjenjë: sytë tuaj janë xixëlluar, shpina juaj është e kërrusur, ju po vështroini një ekran dhe thjesht nuk mund të ndaleni. Nëse kaloni aq shumë kohë në internet, në një telefon, kompjuter, platformë lojërash ose pajisje të tjerash, saqë ndikon negativisht në shëndetin tuaj, punën, financat ose marrëdhëniet tuaja, a mund të konsiderohet një varshmëri?

Ekspertët debatojnë nëse mund të jesh i varur nga interneti, në të njëjtën mënyrë si të jesh i varur nga substancat psikotrope. “Vetë termi varësia nga interneti ose çrregullimi i varësisë nga interneti është i diskutueshëm dhe aktualisht nuk është i shënuar në Manualin Diagnostikues dhe Statistikor të Çrregullimeve Mendore të Shoqatës Amerikane të Psikiatrisë, Edicioni i Pestë (DSM-5), udhëzuesi që praktikuesit përdorin në diagnostikimin e kushteve të shëndetit mendor” (Das & Shapo, 2012, fq 97). Akoma, megjithëse mund të jetë e vështirë të bëhet një dallim midis varshmërisë dhe përdorimit problematik të internetit, detyrimi për të qenë në internet po bëhet gjithnjë e më shumë një shqetësim i njohur.

Në gjuhën shqipe kemi shumë pakë studime që e trajtojnë varshmërinë e nxënësve nga aparatet digjitale si dhe ndikimin e tyre në performancën akademike, andaj është parë e nevojshme të realizohet një studim i tillë. Qëllimi ynë kryesor është të vlerësojmë varshmërinë nga aparatet digjitale tek nxënësit, si dhe të shohim se si kjo varësi ndikon në performancën akademike.

Në këtë studim trajtohet në mënyrë të detajuar varshmëria nga teknologjitë digjitale, si një formë e varësisë jokimike, që përfshin një ndërveprim të tepruar individ-pajisje teknologjike. Motivi ynë që ta studiojmë këtë çështje ishte në atë që duke parë se përdorimi i teknologjive digjitale sjell shumë të mira dhe lehtësira në jetën e përditshme, por ndonjëherë mbipërdorimi i tyre mund të jetë edhe i dëmshëm, duke çuar kështu në varshmëri ndaj tyre. Një gjë e tillë vihet re sidomos tek nxënësit, të cilët janë grupi shënjues që e përdorin më shumë internetin.

I. KORNIZA TEORIKE

1.1 Varshmëria nga teknologjitë digjitale

“Varësia digjitale mund të përcaktohet si përdorimi i tepërt i internetit ose elektronikës, deri në pikën që ndikohet në jetën e përditshme të dikujt. Mund të ndahet në disa versione të ndryshme: varshmëri nga telefonit, varshmëri nga mediet sociale dhe varshmëri nga interneti. Ndonjëherë, nëse bëhet varshmëria digjitale e pakontrolluar, mund të lidhet me çrregullime, të tilla si: depresioni, ankthi, mosfunksionimi shoqëror dhe çrregullime të tjera të kontrollit të impulsit” *Grohol (2005, fq. 25-31)*. Pavarësisht nga debati, nëse përdorimi i tepruar i teknologjive të ndryshme të tilla si surfimi në internet, shikimi i televizorit dhe lojërat kompjuterike, mund të quhet ose duhet të quhet një "varshmëri", studiuesit kanë argumentuar se përdorimi i tepërt i teknologjisë mund të konsiderohet problematik.

Rrjedhin nga kriteret e lidhura me bixhozin patologjik në Diagnostikimin dhe Statistikën Manual - Edicioni i katërt (DSM-IV; Shoqata Amerikane e Psikiatrisë, 1994), *Roku (2013)*, paraqiti një përkufizim për çrregullimet e lidhura me internetin, të quajtur Përdorimi Problematic i Internetit. Ky përkufizim kërkon që individët të plotësojnë pesë nga tetë kriteret për varshmërinë nga interneti, për t'u kualifikuar si të varur. Këto përfshijnë:

- preokupim me internetin,
- nevojën për një kohë më të gjatë në internet,
- përpjekje të përsëritura për të zvogëluar përdorimin e internetit,
- tërheqje kur zvogëlon përdorimin e internetit,
- kohë-çështjet e menaxhimit,
- shqetësimi mjedisor (familja, shkolla, puna dhe miqtë),
- mashtrimi rreth kohës së kaluar në internet, dhe
- modifikimi i humorit përmes përdorimit të Internetit” *Roku (2013, fq. 114)*.

Roku (2013), e karakterizoi varshmërinë nga interneti si qëndrimi në internet, për kënaqësi, kryesisht në bisedë, e cila zgjat mesatarisht 38 orë ose më shumë në javë. Ai, arriti në përfundimin se “varshmëria nga interneti mund të shkatërrojë familjet, marrëdhëniet dhe karrierën” *Roku (2013, fq. 115)*. Studimet e kaluara që ekzaminojnë varshmërinë nga interneti, kanë gjetur një përdorim dukshëm dhe më të lartë të aplikacioneve të internetit të komunikimit sinkron, si mesazhet e çastit (IM) nga nxënës të varur nga interneti, krahasuar

me atë të nxënësve të pavarur.

Bhatina & Sharma (1998), treguan se njerëzit që janë të varur nga interneti, e përdorin atë intensivisht, veçanërisht për komunikim në internet përmes postës elektronike. Ekzistojnë pikëpamje të ndryshme në lidhje me varshmërinë nga interneti dhe përkufizimet e varshmërisë nga interneti . Sidoqoftë, ekziston një marrëveshje që varshmëria në Internet të ndodhë edhe pse nuk ka një përkufizim të standardizuar të varshmërisë nga interneti. “Termi i referohet dështimit për të ndaluar dëshirën për përdorim të tepruar të internetit, ndjenjat e nervozizmit ekstrem kur privuan nga interneti duke çuar në hidhërim të dukshëm dhe dëmtime funksionale në jetën e përdoruesve të tillë si vështirësi psikologjike, sociale, akademike dhe / ose të punës” *Bhatina & Sharma (1998, fq. 145-146)*.

Varshmëria nga interneti përkufizohet përgjithësisht si një lloj varshmërie psikologjike, që përfaqëson nevojën për të qëndruar në internet. *Das & Shapo (2012)* e përshkruajnë termin, si një lloj varshmërie ndaj teknologjisë dhe një sjellje varshmërie e ngjashme me një zakon të lojërave të fatit. *Morahan- David, Nicole, Ellison , Charles, & Andrew (2012)* përcaktojnë varshmërinë nga interneti si përdorim i tepruar i internetit, moskontrollimi i përdorimit të internetit dhe si potencial për të çuar një problem serioz në jetën e individit. *Davis, Flett, & Besser (2002)*, e identifikojnë atë si përdorim të tepruar të Internetit, që mund të ndodhë të bëjnë që një individ të ketë vështirësi në shtëpi, në punë, në shkollë dhe në jetën shoqërore ose psikologjike.

Grohol (2005), e përcaktoi atë si një sindromë shumëdimensionale, duke përfshirë simptomat njohëse, emocionale dhe të sjelljes, pra duke shkaktuar probleme në trajtimin e përdorimit të internetit. *Koa, Yneb, & Chenb (2012,)* përkufizuan varësinë nga interneti si varësi psikologjike ndaj internetit dhe konsiderohen si aktivitete në rritje në internet, ndjenja të pakëndshme, kur jeni jashtë linje dhe rritja e tolerancës ndaj Internetit, më në fund si mohim i sjelljes problematike. “Varësia nga interneti zakonisht shkakton humbjen e kontrollit, tërheqjen, dobësimin e funksionit, për të zvogëluar aftësinë e vendimmarrjes dhe të shkaktojë surfimin në internet, me gjitha ndikimet negative në mirëqenien sociale dhe psikologjike” *Goel, Subramanyam, & Kamath (2013, fq. 55-56)*.

Karakteristikat e përbashkëta të këtyre përkufizimeve, theksojnë gjatësinë e kohës në internet dhe të nervozizmit, pra shqetësimin dhe nervozizmin në kohë pa përdorim të internetit. Literatura në përgjithësi sugjeron, që ekzistojnë disa përbërës të varshmërisë nga interneti. *Roku (2013)*, argumenton se varshmëria nga interneti ka katër komponentët:

(1) “përdorimi i tepruar i internetit, shpesh i shoqëruar me humbjen e sensit të kohës ose neglizhencën në disqet themelore;

(2) tërheqja, duke përfshirë ndjenjat e zemërimit, tensionit dhe / ose depresionit kur kompjuteri është i paarritshëm;

(3) toleranca, përfshirë nevojën për pajisje më të mira kompjuterike, më shumë softuer ose më shumë orët e përdorimit;

(4) pasojat negative, përfshirë argumentet, gënjeshttrat, arritjet e dobëta, izolimin shoqëror dhe lodhjen” *Roku (2013, fq. 131-132).*

Studimet vazhdojnë të debatojnë nëse varshmëria nga interneti është një çrregullim, si dhe çfarë lloj çrregullimi është. Në Manualin Diagnostikues dhe Statistikor të Çrregullimeve Mendore (DSM-V), nuk është deklaruar që varshmëria nga interneti është një çrregullim. *Hatice (2011)*, përcaktoi varësinë nga interneti si dëmtimi më i afërt, pra si "Bixhoz patologjik", i cili është nën titullin e çrregullimit të kontrollit të impulsit në DSM-IV dhe i cili nuk përfshin abuzimin e çdo materiali. Kur efektet negative mendore, sociale, ekonomike, kulturore dhe efektet arsimore, të shkaktuara nga varshmëria në internet janë konsideruara, është e nevojshme për të bërë më tej të detajuara hulumtimet, për të sqaruar dhe identifikuar këtë lloj varshmërie.

1.2 Arsimimi dhe shoqëria digjitale

Shoqëria post-kapitaliste, vazhdimisht po ia lëshon vendin shoqërisë digjitale, e cila karakterizohet me ndërrime ekonomike në shoqëri, të cilat u japin trajtim të njëjtë burrave dhe grave, si dhe favorizojnë profesionet intelektuale. Të gjitha reformat ekonomike krijojnë gjithnjë e më tepër hapësirë për individët e shkolluar, ku do të zhvillohet arsimi, distribuimi dhe konsumi i bashkësive në shekullin XXI. Nëse bazohemi në doktrinën se detyra kryesore e arsimit është që të përgatit gjeneratën e re për punë, motivimin e nxënësve që të kalojnë fazat, standardet e shkollimit të përpiluara nga shteti, dhe që të arrihet ai kualifikim, atëherë mund të themi se detyrë parësore në periudhën e transformimeve luan kurrikulumi, dhe përshtatja e tij ndaj nevojave të ardhshme për plotësimin e kërkesave të njeriut, pra profesionet e reja. *Jashari (2015).*

Sipas *Jasharit (2015)*, revolucioni i ri teknologjik ka sjell ekspansionin të elektronikës. Kompjuterizimi, rrënjësisht ndërron qasjen e njeriut ndaj punës dhe veprimtarive ekonomike në tërësi. Ajo që ishte në kohën e industrializimit lapsi dhe fletorja dhe njeriu i cili shkruan, llogarit, vizaton jep kahe punës dhe hapave të ardhshëm, tani është kompjuteri i cili këto

gjëra i mbledh në një vend, i ruan dhe i bën të lëvizshme dhe të përdorshme, sipas nevojave të njeriut, i cili prapë është kryesori në këtë proces. Por puna është bërë me mijëra herë më e lehtë për t'u kontrolluar dhe për t'u drejtuar, e lidhur me një pikë komandimi. Ndërrimi i rrënjësishëm i profesioneve, është një proces që shkon krahas zhvillimit tekniko-teknologjik. Dikur kanë qenë në zë mjeshtërit e punimit të armëve, kaligrafistët, astrologët, qerrepuuesit e qerreve me kuaj, kapitenët e anijeve me vela etj., sot kemi kompjuteristë, modelistë, nutricionistë, stilistë, astronautë, pilotë, etj. Dikur librat janë shkruar në papirus, sot kjo bëhet në më tepër mënyra, dhe në mënyrë jashtëzakonisht të shpejtë dhe të përdorshme në sasi dhe cilësi të lartë. *Jashari (2015)*

1.3 Lidhja e varshmërisë nga teknologjitë digjitale me performancën akademike në shkollë të nxënësve

Nëse performanca akademike dhe përdorimi i internetit janë të lidhura mes vete, kjo ka qenë prej kohësh interes i studiuesve. *Kyugnhe & Enjung (2006)*, anketuan 531 nxënës, rreth përdorimit të tyre të internetit, duke përdorur një listë kontrolli prej 10 simptomave klinike, për të paralelizuar simptomat e abuzimit dhe varshmërisë së substancave. “Rezultatet treguan se 13% e grupit të mostrës që e raportuan përdorimin e internetit, thonë se përdorimi i internetit kishte ndikim në performancën e tyre akademike, performancën profesionale, ose jetën shoqërore” *Kyugnhe & Enjung (2006, fq. 45)*. Në të njëjtën linjë të hulumtimit, *Barber (1997)* gjithashtu zbuloi se 86% e mësuesve të anketuar, besuan se me përdorimin e internetit nga fëmijët, nuk përmirësohet performanca akademike; mësuesit argumentuan se informacioni që nxënësit morën ishte shumë i paorganizuar dhe i palidhur me programin shkollor *Barber (1997, fq. 411)*.

Në mënyrë të ngjashme, *Kubey et al. (2001)* zbuloi se përdorimi i rëndë i internetit për kohën e lirë, ishte shumë i ndërlidhur me performancën akademike të dëmtuar. Studiuesit argumentuan se cilësitë unike shoqërore të aplikacioneve të tilla, përfaqësonin një dobi më domethënëse për individët e vetmuar që mund të jenë me miqtë në çdo kohë; si rezultat, shumë përdorues mbaheshin zgjuar natën vonë, dhe ndiheshin të lodhur të nesërmen, gjë që ndikoi në performancën e tyre akademike. Në një studim të fundit, u zbulua se përdorimi më i madh i internetit shoqërohej me aftësi më të mira leximi, sidomos për të rinjtë që janë fillimisht në nivel të ulët në aftësitë e të lexuarit. Në kontrast, megjithatë, *Chakraborty, Basu, & Kumar (2010)*, zbuluan se përdoruesit e dritës së internetit, kishin marrëdhënie më të mira me stafin administrativ, më mirë notat akademike dhe kënaqësinë e mësimit më të lartë se përdoruesit e shumtë. Përdoruesit e varur të internetit kishin më shumë të ngjarë të jenë në

depression, të sëmurë fizikisht, të vetmuar dhe introvertë, se përdoruesit jo të varur të internetit.

Në studimin e TIK-ut, *Lois & Paul (2012)*, zbuluan se si niveli i përdorimit të TIK-ut dhe niveli i varshmërisë nga TIK-u, ka korrelacione të konsiderueshme dhe pozitive bivariale, me uljen e performancës akademike midis adoleshentëve në Kinë. Kur shqyrtohej ndikimi relativ i parashikuesve të ndryshëm në uljen e performancës akademike, regresioni hap pas hapi tregoi se katër simptoma të varshmërisë nga TIK-u (domethënë, preokupimi nga TIK-u, humbja e kontrollit, humbja e marrëdhënies për shkak të përdorimit të tepërt dhe arratisjes), ishin parashikuesit më të fortë për uljen e performancës akademike. “Bazuar në këtë literaturë, është e arsyeshme të besojmë se për të qenë i shkolluar në internet (veçanërisht në mjete, shkrim-lexim kritik dhe social-strukturor), mund dhe do të ketë një ndikim pozitiv në performancën akademike të dikujt, sepse, sipas përkufizimit, njohuria në internet do të thotë të jesh në gjendje të gjeshe, të rimarrësh, të interpretosh dhe të vlerësosh kontekstin nën të cilin informacioni u krijua ose u prodhua. Një aftësi e tillë, do të lehtësojë individët me aftësi më të larta në zgjidhjen e problemeve akademike” *Lois & Paul (2012, fq. 715)*.

1.4 Varshmëria nga teknologjitë digjitale dhe emocionet e fëmijëve

Varësia nga interneti midis fëmijëve është një shqetësim në rritje. Aksesit në internet është një pjesë jetike e botës moderne, dhe një mjet i rëndësishëm në arsimimin e fëmijëve tanë. Përveç kësaj, është një medium mjaft argëtues dhe informues. Sidoqoftë, vetë këto cilësi e bëjnë atë një arratisje joshëse për shumë fëmijë. Ata mund të jenë çdokush në një dhomë bisede në internet, ose të luajnë lojëra drithëruese dhe sfiduese kundër lojtarëve të tjerë nga të gjitha anët e globit. “Me një klik të miut, ata mund të hyjnë në një botë tjetër, ku problemet që ata perceptojnë në jetën e tyre reale nuk janë më të pranishme, dhe të gjitha gjërat që dikush dëshiron të jetë, të bëjë ose të përjetojë, janë të mundshme”. *Goel, Subramanyam, & Kamath (2013, fq. 115)*

Ashtu siç është varshmëria ndaj drogës dhe alkoolit, interneti u ofron fëmijëve dhe adoleshentëve një mënyrë për t'i shpëtuar ndjenjave të dhimbshme ose situatave shqetësuese. Ata sakrifikojnë orët e nevojshme të gjumit, për të kaluar kohën në internet dhe të tërhiqen nga familja dhe miqtë, për të ikur në një botë të rehatshme në internet, që ata kanë krijuar dhe formuar.

Fëmijët të cilëve u mungojnë marrëdhëniet shpërblyese ose ushqyese, apo që vuajnë nga aftësi të dobëta sociale dhe përballuese, rrezikojnë më shumë të zhvillojnë zakone të

papërshtatshme ose të tepruara në internet. “Për shkak se ata ndihen vetëm, të huaj dhe mund të kenë probleme për të bërë miq të rinj, ata u drejtohen të huajve të padukshëm në dhomat e bisedave në internet, duke kërkuar vëmendjen dhe shoqërinë e humbur nga jeta e tyre reale. Ata mund të vijnë nga familje me probleme të konsiderueshme në shtëpi, ose të përjetojnë ngacmim apo vështirësi në shoqërim në shkollë dhe aktivitete jashtëshkollore, kështu që, ata të përballen me problemet e tyre duke kaluar kohë në internet. Në shoqëri, ata mësojnë të dërgojnë mesazhe të çastit tek miqtë, sesa të zhvillojnë marrëdhënie ballë për ballë, të cilat mund të ndikojnë në mënyrën e tyre të marrëdhënies me kolegët” *Beard & Wolf (200, fq. 825).*

1.5 Lidhja midis varshmërisë nga teknologjitë digjitale dhe gjinisë

Studiuesit supozojnë se gjinia luan një ndikim të rëndësishëm mbi përdorimin problematik të internetit. Duke mbështetur këtë, disa studime kanë raportuar për gjininë dhe ndryshimet në përdorimin e internetit . Kjo hipotezë mbështetet edhe në faktin se më shumë meshkuj sesa femra përdorin internetin në të gjithë botën. Për më tepër, ajo mbështetet në një pikë kulturore e paraqitur nga *Tsai et al. (2009)*. “Ky është fakti që nxënësit e gjinisë femërore, më shpesh mbikëqyren nga familjet e tyre sesa meshkujt, sidomos në kulturat lindore, të cilat mund të rezultojnë në përdorimin jonormal të internetit nga meshkujt” (*Eastin, Grenberg, & Hofschire, 2006, fq. 94*).

1.5.1 Lidhja midis varshmërisë nga teknologjitë digjitale dhe pasojave psiko-sociale

Për disa dekada, ka pasur mjaft studime që hetojnë shoqatat midis varshmërisë nga interneti dhe variablave psiko-sociale. Studimet e deritanishme, kanë zbuluar se përdorimi i internetit mund të parashikojë ndryshime të ndryshme në mirëqenien psikologjike, dhe se burimet shoqërore mund të moderojnë ndryshimet. “Kryesisht, komunikimi i njerëzve, burimet shoqërore dhe variablat psikosociale, janë të lidhur ngushtë, që do të thotë më sesa shumë ndihmë komunikuese të ketë, mund të kemi aq më shumë burime shoqërore, dhe për këtë arsye funksionim më të mirë psikologjik, nivele më të ulëta të stresit dhe lumturi më të madhe” (*Thatcher & Goolam (2005, fq. 516)*).

Mund të konkludohet se njerëzit e vetmuar dhe të dëshpëruar, mund të kalojnë më shumë kohë vetëm ose të ketë marrëdhënie negative me të tjerët. Shkurtimisht, është e

mundur të thuhet se ata njerëz, mund të priren në përdorimin e tepërt të internetit, dhe gjithashtu, të jenë të varur nga interneti. Shumë studime kanë kërkuar marrëdhëniet midis varshmërisë nga interneti dhe ndryshimet psiko-sociale për disa dekada.

1.5.2. Lidhja midis varshmërisë nga teknologjitë digjitale dhe depresionit

Lidhja midis depresionit dhe varshmërisë nga interneti, është studiuar në disa studime. “Megjithëse, disa çrregullime shoqërore psikiatrike bashkëjetonin me internetin, u zbulua se varshmëria nga interneti, ka lidhjen më të fortë me depresionin” *Yen et al., (2007, fq.114)*. Duke marrë parasysh literaturën për marrëdhëniet midis varshmërisë nga interneti dhe depresionit, shihet se varshmëria nga interneti është e përhapur tek njerëzit me simptoma depresioni. Depresioni, është një gjë shumëdimensionale, dhe nuk është simptoma e vetme dimensionale psikologjike. Megjithatë, studimet e mëparshme e kanë konsideruar depresionin si një simptomë e vetme dimensionale, dhe nuk i dallonte marrëdhëniet e ndryshme të varshmërisë nga interneti, me dimensione të ndryshme të simptomave depressive.

Hulumtimet në literaturë, kanë gjetur një lidhje midis depresionit dhe përdorimit të internetit *Morrison dhe Gore (2010)*, kanë treguar se njerëzit që e përshkruanin veten si të varur nga interneti, treguan nivele të larta depresioni. Për më tepër, u zbulua se njerëzit që përdorën internetin tepër, kishin depresion më të lartë. “Është vërejtur se njerëzit e përdorin tepër internetin për të lehtësuar vetminë dhe depresionin *Leung (2003, fq. 47)*, sepse kjo lehtësoi depresionin dhe vetminë. Sidoqoftë, ndërprerja e marrëdhënieve shoqërore çuan në probleme shëndetësore dhe depresion të mëtejshëm.

Sidoqoftë, statusi i varshmërisë nga interneti, nuk mund të konsiderohet një parashikues i pandryshuar i depresionit. Prandaj, marrëdhëniet shkakësore duhet të interpretohen me kujdes në studimet e ardhshme, në të cilat varësia nga interneti mund të ndryshojë gjatë studimit *Ko et al., (2014)*, pasi mbetet e panjohur nëse varshmëria nga interneti është shkak ose pasoja e depresionit, dhe pasi që shumica e studimeve janë ndërsektoriale nga ato të parazgjedhurat. Rezultatet e studimeve vunë në dukje se shoqata midis varshmërisë nga interneti dhe depresionit, mund të mos jetë në thelb linear, por mund të jetë një cikël i dyanshëm dhe i mbrapshtë. “Për t’i kuptuar me rregull dhe më mirë marrëdhëniet dykahëshe midis varshmërisë nga interneti dhe depresionit, do të duhej të ishte e nevojshme dhe e dobishme për të bërë studime duke përfshirë analizën e rrugës njëdrejtimore” *Yang et al., (2014, fq. 411)*. Shkurtimisht, marrëdhëniet e varshmërisë nga interneti me dimensione të

shumta të depresionit duhet të kërkohen më tej.

1.5.3 Lidhja midis varshmërisë nga interneti dhe vetmisë

Një tjetër variabël që lidhet me varshmërinë nga interneti është vetmia. “Besohet se interneti ka potencial për të shkaktuar izolim shoqëror dhe për të penguar zhvillimin e aftësive të ndërveprimit shoqëror”, *Das & Shapo (2012, fq. 516)*. Shumë studime kanë treguar se vetmia është e lidhur me përdorimin e detyrueshëm të internetit, *Amichai-Hamburger & Ben-Artzi (2003)*. “Vetmia përcaktohet si një emocion i pakëndshëm depresiv, për shkak të mungesave cilësore dhe sasiore në rrjetin social të individit, *Peplau & Perlman (1982, fq. 147)*. Vetmia ndodh kur marrëdhëniet ndërpersonale nuk mund të plotësojnë kërkesat shoqërore dhe nevojat personale. Konsiderohet se luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e varshmërisë nga interneti. Është gjetur se vetmia është një nga parashikuesit më të mirë të varshmërisë nga interneti.” Individët e vetmuar mund të shprehen më mirë, kur ata janë në internet, krahasuar me periudhën kur janë jashtë linjës” *Katz (1973, fq. 74)*.

Kërkimet e mëparshme kanë treguar se njerëzit e varur nga interneti përjetojnë tjetërsim në marrëdhëniet e tyre shoqërore, madje edhe mund t'i japin fund këtyre marrëdhënieve, pasi interneti bëhet faktori kryesor shoqëror në jetën e tyre. *Patrice (1995)*. propozon që nivelet e larta të përdorimit të internetit, mos lidhen me nivele të larta të vetmisë emocionale, por me nivele të ulëta të vetmisë shoqërore. “Në fakt, individët e vetmuar mund të zhvillojnë një preferencë për shoqërinë në internet me ndërveprim, që mund të çojë në varshmëri nga interneti” *Katz (1973, fq. 75)*. Studimet ia atribuojnë vetminë deri në ulje të komunikimit familjar, aktiviteteve shoqërore, mirëqenies dhe lumturisë. Në një studim tjetër nga *Joins (2001)*, u zbulua se izolimi social u rrit me përdorimin e internetit. U zbulua që pjesëmarrësit të cilët ishin duke përdorur internetin më shumë se pesë orë në javë, shpeshtuan kohën e tyre në internet, duke reduktuar kohën e tyre me miqtë dhe familjen. Ka rezultate kontradiktore nëse vetmia zvogëlohet apo rritet me përdorimin e internetit. Megjithatë, disa nga studiuesit kanë vërejtur internet patologjik tek përdoruesit që kanë nivel më të lartë të vetmisë, dhe ata ndërveprojnë më pak me kolegët e tyre. Në të kundërt, këto studime tregojnë se përdorimi i internetit lehtëson shoqërimin. Një studim tjetër tregoi se “njerëzit e vetmuar përdorin internetin më shpesh, sepse interneti siguron një atmosferë sociale për të bashkëvepruar me të tjerët” *Whitty & McLaughlin (2007, fq. 145)*.

1.5.4 Lidhja në mes varshmërisë nga interneti dhe ankthit shoqëror

Studimet e deritanishme vendosin se varësia nga interneti lidhet me ankthin shoqëror (Caplan, 2007; Ko et al., 2012; Ko et al. (2014). “Ankthi social është zakonisht më i ulët gjatë ndërveprimit në internet sesa ndërveprimi ballë për ballë” Yen et al., (2012 fq. 68). Mund të argumentohet se njerëzit ndjehen të shqetësuar, kur janë në mjedise shoqërore, sepse atyre u mungojnë aftësitë e nevojshme shoqërore të cilat ndikojnë në jetën e individëve. Po kështu, mund të thuhet se nivelet e perceptimit të individëve me ankth të lartë shoqëror, në lidhje me mënyrën se si ata perceptohen dhe vlerësohen nga të tjerët, ndikojnë në nivelin e tyre të ankthit. Njerëzit që vuajnë nga ankthi, shpesh kanë shumë probleme në komunikimin dhe bashkëveprimin me të tjerët në një mënyrë të shëndetshme, pozitive dhe kuptimplote. Këto karakteristika njerëzore, shihen si përcaktuese të rëndësishme të varshmërisë nga interneti. Haxhiymeri (2011), zbuloi se individët me ankth shoqëror, mund të preferojnë aktivitetet në internet; d.m.th., njerëzit që kanë ankth të ndërveprimit shoqëror, kalojnë pjesën më të madhe të kohës në internet. Me pak fjalë, mundet të nxirret në përfundim se ankthi është një faktor i rëndësishëm për të vlerësuar, kur merret parasysh varshmëria nga interneti.

1.5.5 Lidhja mes varshmërisë nga interneti dhe vetëvlerësimit

Sa i përket vetëvlerësimit, mund të konsiderohet si një koncept i lidhur me varshmërinë nga interneti. “Vetëvlerësimi përcaktohet si qasja e personit ndaj vetvetes, e cila mund të jetë pozitive ose negative. Gjithashtu, konsiderohet i lartë kur një person e percepton veten pozitivisht, por vlerësohet si vetëvlerësim i ulët nëse personi e percepton veten negativisht” Eastin, Grenberg, & Hofschire (2006, fq. 654). “Konsiderohet vetëvlerësim i ulët si një faktor rreziku i përdorimit problematik të internetit, pasi vetëvlerësimi i ulët është në mënyrë konceptuale dhe empirike një funksion të refuzimit ose braktisjes së perceptuar” Douglas et al., (2008, fq. 411). Një marrëdhënie midis vetëvlerësimit dhe varshmërisë nga interneti është krijuar nga studime të ndryshme Bozoglan et al., (2013); Douglas et al., (2008); Kim & Davis (2009); Sobell (2007); Yang & Tung (2007).

Nivelet e ulëta të vetëvlerësimit shkaktojnë mosbesim ndaj vetvetes, personalitet të varur, humbje të kontrollit dhe dështim. Vetëvlerësimi i ulët ndikon në intensitetin e përdorimit të detyrueshëm të internetit. Studimet në lidhje me marrëdhëniet midis varshmërisë nga interneti dhe vetëvlerësimit, tregojnë se ai është më i ulët kur varshmëria nga interneti është e madhe. Me fjalë të tjera, individët që kanë vetëvlerësim të ulët përdorin

internetin më tepër, sepse përdorimi i internetit do të thotë të shpëtosh nga problemet e vetëvlerësimit.

1.5.6 Lidhja midis varshmërisë nga interneti dhe kënaqësisë nga jeta

Studiuesit tregojnë se ekziston një lidhje e rëndësishme midis varshmërisë nga interneti dhe kënaqësisë nga jeta *Chou & Hsiao (2000); Kraut et al., (1998); Meerkerk et al., (2010)*. “Kënaqësia nga jeta përcaktohet në lidhje me synimet e arritura dhe të vendosura nga një individ, si dhe vlerësimin pozitiv të jetës së dikujt në lidhje me këto objektiva” *Erikson (1968 fq. 611)*. “Kënaqësia nga jeta i referohet gjendjes së mirëqenie, s që tregohet nga emocione të ndryshme pozitive si lumturia dhe morali, gjithashtu, edhe ndjenjat tjera pozitive në lidhje me marrëdhëniet e përditshme *Bulut-Serin (2011 fq. 91)*.”

Studimet në literaturë, vërejnë marrëdhëniet reciproke midis varshmërisë nga interneti dhe kënaqësisë nga jeta. « Varshmëria nga interneti ka një ndikim në kënaqësinë e jetës, ndërsa kënaqësia nga jeta nuk ndikon në varshmërinë nga interneti” *Bozoglan et al, (2013, fq. 55-56)*. Megjithatë, disa studime tregojnë se, me pasjen e aksesit në internet, rriten edhe nivelet e kënaqësisë nga jeta . Në të kundërt, studime të tjera tregojnë se njerëzit e varur nga interneti janë më pak të lumtur, ose kanë më pak kënaqësi nga jeta . Me fjalë të tjera, ekziston një marrëdhënie negative midis kënaqësisë nga jeta dhe varshmërisë nga interneti.

1.5.7 Lidhja midis varshmërisë nga interneti dhe mbështetjes sociale

Studimet në lidhje me shoqërimin midis varshmërisë nga interneti dhe mbështetjes sociale, tregojnë se këto dy koncepte janë të ndërlidhura mes vete. Mbështetja sociale është llogaritur si një parashikues i rëndësishëm i varshmërisë nga interneti . “Mbështetja sociale përcaktohet si plotësimi i nevojave thelbësore siç është vetë-realizimi, një ndjenjë e përkatësisë, dashuria dhe vlerësimi, *Davis, Flett, & Besser (2002, fq. 87-88)*. Akademikë të tjerë kanë përcaktuar mbështetjen sociale si një kontakt ndërpersonal, në lidhje me pohimin, ndihmën, ndikimin, inkurajimin dhe ndjenjat *Leung & Lee, (2005)*. *Kraut (2002)*, theksoi se njerëzit që kalojnë më shumë kohë në internet, kishin rrjete më të mëdha sociale, duke ndërvepruar ballë për ballë me të afërmit, familjen dhe miqtë.

Studimet e përdorimit të internetit dhe mbështetjes sociale, kanë dhënë edhe gjetje tjera të ndryshme. *Cummings, Sproull dhe Kiesler (2002)*, vendosën që t'i ndihmonin grupet

në internet, për të gjetur njerëz me përvoja të ngjashme, dhe të zhvillojnë orientim më të fortë në bashkësi dhe në mbështetjen sociale. *Shaw dhe Gant (2002)*, gjithashtu, zbuluan sesa shpesh përdorimi i internetit lidhej me një mbështetje të rritur sociale të perceptuar. *Chen, Li dhe Long (2007)*, vunë re se njerëzit me mbështetje më të lartë sociale, kishin një faktor rreziku për një nivel më të lartë të varshmërisë nga interneti. Sidoqoftë, *Chou dhe Hsiao (2000)*, zbuluan se përdorimi i tepruar i internetit, ulte ndërveprimet ballë për ballë dhe kohën për të njohurit; kështu, kjo bën që të izoloohen nga shoqëria, prandaj këta njerëz u bënë më të vetmuar nga koha.

1.5.8 Lidhja mes varshmërisë nga teknologjitë digjitale dhe pasojave të tjera

Përdorimi i tepërt i interneti është raportuar nga *Akhter (2013)*, që "ndikon negativisht në shëndetin fizik dhe jetën familjare". Për më tepër, disa studime gjithashtu treguan ndikimin psikologjik të internetit, "varësia si mungesë e angazhimit shoqëror dhe ulje e produktivitetit fizik, ndikojnë si probleme muskulore të shpinës / qafës, sindroma e tunelit, kyçit të dorës dhe çrregullimi i gjumit, të cilat janë shumë të dëmshme për trurin e adoleshentëve dhe të rriturve të rinj" *Saisan, Smith, Robinson, & Segal (2013, fq. 411)*. Duke përjashtuar efektet e tilla anësore të përdorimit problematik të internetit, ky studim, në veçanti, është kryer për të eksploruar marrëdhëniet midis varshmërisë nga interneti midis nxënësve të shkollave të mesme dhe performancës së tyre akademike. Studimi, gjithashtu, kërkon të detajojë këto marrëdhënie, duke u përpjekur të ndriçojë ndikimin e varshmërisë nga interneti në lëndët e ndryshme shkollore.

Sipas *Lin dhe Tsai (2002)*, njerëzit e varur nga interneti, priren të kalojnë më shumë kohë në internet dhe ngazëlleen derisa janë në internet. "Simptomat tregojnë se interneti ndikon negativisht në jetën e tyre, në zona si shkollat, shëndeti dhe marrëdhëniet me prindërit. Nga pikëpamja e klinikëve, përdoruesit e internetit mund të zhvillojnë karakteristika të tilla si depresioni, çrregullimi bipolar, detyrimi seksual ose vetmia" *Morahan-Martin (2005, fq. 215)*. *Yang dhe Tung (2007)*, sugjeruan që ata të cilët janë me çrregullime psikologjike, të tilla si varësia, ndrojtja ekstreme, depresioni dhe vetëvlerësim i ulët, kishin prirje më të lartë për të zhvilluar varshmëri nga interneti.

Diskutohet gjithashtu, nëse varësia nga interneti është një situatë e përkohshme apo e përhershme, dhe nëse mbetet e njëjtë ose ndryshon nga koha. Disa studiues sugjeruan që, varshmëria nga interneti është afatshkurte, situatë e cila do të ulej në mënyrë progresive kur

kalon koha, *Kraut et al., 1998; Widyanto & McMurren (2004)*. Supozohet që varshmëria nga interneti është "një fenomen i përkohshëm për disa individë, ka të ngjarë të ketë lidhje me rritjen fillestare të internetit, dhe duke u lodhur me familjaritetin e shtuar " *Widyanto & McMurren (2004, f. 444)*. Është raportuar gjithashtu, nga *Young*, në studimin e saj të vitit 1998, shihet pothuajse gjysma e njerëzve të vetë-përcaktuar dhe të varur nga interneti, kishin qenë në internet për më pak se një vit. Disa këndvështrime të tjera sugjerojnë që, vështirësitë e jetës reale mund të rrisin varshmërinë nga interneti për një kohë, pasi interneti mund të ndihmojë njerëzit të shpëtojnë nga ngjarjet stresuese të jetës, *Armstrong, Phillips, & Saling (2000)*.

"Interneti ka disa aspekte pozitive dhe mund të jetë informues, i përshtatshëm, i shkathët dhe argëtues kur përdoret normalisht *Shapira, Lessing, & Goldsmith (2000, fq. 115)*, megjithatë, përdorimi i tepruar i ndërhyrjes në internet me jetën e përditshme, mund të shoqërohet me probleme të ndryshme si ulja e mirëqenies psiko-sociale, prishja e marrëdhënieve dhe neglizhenca nga përgjegjësitë shtëpiake, sociale, akademike dhe të punës. "Individët që përdorin internetin intensivisht, kanë më pak ndërveprim me miqtë dhe familjet, dhe ndajnë më pak kohë me ta, duke jetuar në nivele të larta të vetmisë dhe stresit" *Kyunghe & Enjung (2006 fq. 841)*. *Nie & Erbring (2002)*, pretendojnë se përdorimi i detyrueshëm i internetit dhe moskontrollimi i kohës së shpenzuar në internet, mund të çojë në probleme të menaxhimit të kohës. Studime shtesë, gjithashtu, tregojnë se sjelljet ndërpersonale dhe problemet janë të lidhura me varshmërinë nga interneti. "Përdoruesit e varur nga interneti, mund të kenë sjellje të papërshtatshme të ngrënies, po ashtu dhe dietë të dobët, gjë që mund të ndodhë si rezultat i problemeve që lidhen me rritjen dhe zhvillimin" *Wang, Zhou, & Lu (2011 fq. 511)*. *Joins (2001)*, deklaroi se përdoruesi problematik i internetit, mund të ketë zakone të mundshme personale të varshmërisë, si pirja e duhanit, pirja e alkoolit ose kafesë, dhe marrja e substancave narkotike.

1.6 Simptomat që tregojnë varshmërinë nga interneti

1.6.1 Simptomat emocionale të varshmërisë në internet

Simptomat e mëposhtme janë tipike për të varurit nga interneti:

- Ndjenjat e fajit
- Ankthi

- Depresioni
- Pandershëmëria
- Ndjenjat euforike kur ndodhen para kompjuterit
- Nuk mund të mbahen oraret
- Nuk ka kuptim të kohës
- Izolimi
- Mbrojtja.

1.6.2 Simptomat fizike të varshmërisë nga interneti

Simptomat e mëposhtme, janë karakteristike për dikë që përdor kompjuterin, për një periudhë shumë të gjatë kohore:

- Dhimbje të shpinës
- Dhimbjet të kokës
- Shtimi ose humbja e peshës
- Çrregullime të gjumit
- Sindroma e tunelit të kyçit të dorës
- Vizioni i turbullt ose i tendosur.

1.6.3 Shenjat e sjelljes së varshmërisë nga interneti:

- Gara rastësore, ku sesionet e qëndrimit në teknologjitë digjitale zgjasin tërë ditën apo tërë natën,
- Ngrënie e shpeshtë e vakteve përpara kompjuterit ose shmangie totale e tyre,
- Përdorimi i rregullt i teknologjive digjitale deri në orët e vona, pavarësisht se individit ka për t'u ngritur herët të nesërmen në mëngjes,
- Përpjekje të shumta për të reduktuar përdorimin e teknologjive digjitale, që rezultojnë me pak ose aspak sukses,
- Të qenit në aparate digjitale për çdo lloj mundësie që i ofrohet,

- Të shpenzuarit gjithnjë e më shumë kohë në teknologjitë digjitale dhe gjithnjë e më pak kohë me të tjerët në jetën e përditshme,
- Të qëndruarit shpesh në teknologjitë digjitale, duke neglizhuar përgjegjësitë e tjera të rëndësishme (shkolla, familja, punët e shtëpisë),
- Shfaqje e nervozizmit apo fyerjes kundrejt pyetjeve që bëhen në lidhje me kohën që kalon në teknologjitë digjitale.
- Nëse është student, ulet koha e studimit duke shfaqur performancë të varfër akademike, Taffel (2001).

1.7 Varshmëria nga interneti dhe lojërat online

Në 2018, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH), përfshiu një gjendje të lidhur dhe të njohur si çrregullim i lojërave në edicionin e 11-të të Klasifikimit Ndërkombëtar të Sëmundjeve (ICD). “Çrregullimi i lojërave përcaktohet si "një model i sjelljes së lojërave ('lojëra digjitale' ose 'video-lojëra'), që karakterizohet nga kontrolli i dëmtuar i lojërave, duke i dhënë përparësi lojërave ndaj aktiviteteve të tjera deri në atë masë, sa që lojërat të kenë përparësi mbi interesat e tjera dhe aktivitetet e përditshme, vazhdimësinë ose përshkallëzimin e lojërave, pavarësisht nga shfaqja e pasojave negative”, *Eastin, Grenberg, & Hofschire (2006, fq. 411)*.

Nëse varshmëria nga interneti përbën një çrregullim të shëndetit mendor, përdorimi i tepruar i internetit, inkurajon qartazi sjelljet jo të shëndetshme, shpesh në të njëjtën mënyrë që bëjnë varshmëritë e njohura. Nëse shqetësoheni se po e teproni, këtu janë shenjat për të kërkuar dhe mënyrat për të ndihmuar në menaxhimin e të qenit në internet.

1.8 Lidhja në mes varësisë nga interneti dhe performancës akademike në kontekstin shqiptar

Ndryshe nga kultura e vendeve të tjera, familjet shqiptare parapëlqejnë të mbajnë kompjuterët në dhomat e fëmijëve të tyre, duke e ulur kështu nivelin e kontrollit të konsumit të internetit. Studimi i Lekajt (2018) tregon se 47% e tyre janë kontaktuar online nga persona të panjohur. Një dukuri e tillë është evidentuar gjithashtu edhe nga studimi ynë ku 43.8% e të anketuarve janë shprehur se pikërisht kontakti me persona të panjohur dhe vulgarë është një

rrezik i mundshëm për ta. Shumë orë përpara kompjuterit ndikojnë për keq në formimin e fëmijëve. I bëjnë të rriten në një botë të shkëputur nga realiteti, të varur nga kompjuteri, nga video-lojërat dhe *chati*.

Në një studim të kryer në Tiranë nga Zhabaj (2014), ku kishte për qëllim identifikimin e varësisë që kanë fëmijët në përgjithësi nga interneti dhe në veçanti tek nxënësit e shkollave 9 vjeçare publike dhe private. Në këtë vërtetim kanë marrë pjesë 1000 të anketuar, të cilët janë përzgjedhur rastësisht në ambientet e shkollave publike dhe private si dhe në qendrat e ndryshme të internetit që frekuentohen më së shumti nga fëmijët e këtyre moshave, të vendosura pranë ambienteve të shkollave apo pranë ambienteve të tyre të banimit. Nga rezultatet e studimit doli se përdorimi pa kriter, në kohëzgjatje, shpeshtësi, dhe i pakontrolluar i internetit, nga ana e fëmijëve, ka sjellë si rezultat që për një pjesë të mirë të tyre, ka pasur rënie në mësim, sidomos tek klasat më të larta të këtij cikli shkollor. Koha që një fëmijë duhet të shpenzojë për të studiuar, apo për të kryer detyrat e lëna për në shtëpi, nga ana e mësuesve, harxhon një pjesë të mirë të saj, në përdorimin e internetit, pa llogaritur këtu faktin, se edhe gjatë të mësuarit, mendimi shpesh shkon tek interneti. Shoqata e Sociologëve të Kosovës ka bërë një hulumtim lidhur me përdorimin e internetit te moshat parashkollë e deri tek adoleshentët. Rezultatet në vija të përgjithshme janë se, përdorimi i gjatë i pajisjeve elektronike është i dëmshëm. Fëmijët i ekspozohen radioaktivitetit që është shumë i dëmshëm dhe për fëmijët do të gjenerojë gjenerata, të varur dhe të plogësht dhe nuk do të kenë një perceptim normal çfarë do të kishin fëmijët tjerë”. Sipas këtij studimi, nuk ka ndonjë të dhënë se sa orë në ditë është e lejuar që fëmijët t’i ekspozohen ekranit, por sipas të dhënave, Kosova është në vendin e parë në rajon për nga përdorimi i internetit, duke e marrë parasysh moshën e re, ku mesatarja e moshës është 23.4 për femra, 23.3 për meshkuj. Pra, një popullatë e re e internetit, krahasuar me gjeneratën e viteve “80, ata janë gjeneratë më e plogësht me më shumë informacione, por jo me njohuri dhe dije më shumë se gjenerata e viteve “80. Gjithashtu, Radio Evropa e Lirë ka intervistuar një fëmijë, që thotë se pa lojërat e ndryshme elektronike, apo shikimin e televizorit, nuk e kalon asnjë ditë. – “Unë mendoj se gjenerata ime jemi të varur nga to dhe dëshirojmë edhe të informohemi përmes internetit. Përpos internetit që e shfrytëzoj për informata të ndryshme, unë shikoj edhe filma në I-Pad kryesisht. Pastaj, informohem edhe për aktorë e këngëtarë të ndryshëm, përmes ekranit, qoftë ai kompjuteri, apo iPad ose I-Pod, sepse që të gjitha i kam në shtëpi, që i kam fituar si dhurata nga prindërit për ndonjë festë apo për ditëlindje, Zhabaj (2014).

II. METODOLOGJIA

Qëllimi i këtij kreu është përshkrimi dhe analiza e hollësishme e metodologjisë së përdorur në realizimin e këtij studimi, si dhe analiza e të dhënave të marra nga puna në terren. Në këtë kapitull do të përshkruhen në mënyrë të hollësishme metodat e kërkimit të përdorura në këtë studim, mënyra dhe arsyet përse u përzgjedhën këto metoda, variablat që do të merren në shqyrtim, si u përzgjedh kampioni, si u përzgjedhën instrumentet matëse dhe si u zbatuan, si dhe mënyra se si u realizua analiza dhe përpunimi i të dhënave.

2.1. Problemi i hulumtimit

Studimi trajton fenomenin e varësisë nga interneti, një fenomen i lindur në vazhden e shndërrimeve të vrullshme teknologjike, duke marr kështu përmasa globale. Vendi ynë, krahas ndryshimeve tejet të prekshme dhe të dukshme gjatë periudhës së tranzicionit, padyshim që kohët e fundit është prekur edhe nga fenomeni i varësisë nga interneti. Ky i fundit në vetvete është bërë pjesë integrale e jetës së çdo individi. E megjithatë, jo të gjitha grupmoshat janë ndikuar njësoj nga ky fenomen, ku sidomos, vlen të përmendet dominimi i internetit në periudhën e adoleshencës në të cilën merr rëndësi jetike të jashtëzakonshme. Mund të themi që në vendin tonë hulumtimi dhe trajtimi i këtij fenomeni është në fazën e foshnjërisë. Fenomeni është trajtuar në periudhën e adoleshencës së hershme, dhe gjithashtu ka pasur trajtime të përfshirjes së nxënësve në botën virtuale.

Fëmijët si shtresa më e ndjeshme e shoqërisë për shkak edhe të vet moshës së tyre, më lehtë se çdokush tjetër mund të bien viktimë e teknologjive digjitale, djem apo vajza qofshin ato/ata. Rreziqet më të mëdha që përmbajnë këto teknologji për adoleshentët janë pa dyshim aksesit në lojërat (video-game) të dhunshme, mundësia e të shikuarit fotot e filmimeve jo të përshtatshme për moshën, si dhe ajo e përdorimit të një fjalori jo qytetar, gjëra që normalisht gjenden pa kufi në faqet e internetit me përmbajtje pornografike këto fenomene negative ndikojnë shumë në devijimin e sjelljeve psiko-sociale tek adoleshentët. Rëndësia e eksplorimit të faktorëve kyç psiko-socialë, me natyrë të brendshme e të jashtme, kanë ndikim sinjifikativ në ndërtimin e aseteve për një zhvillim fleksibël të nxënësve. Pyetjet kërkimore të këtij punimi janë:

P1. A ekziston ndërlidhje mes variablave dhe varshmërisë nga teknologjitë digjitale me performancën akademike tek nxënësit ?

- P2. Cilat janë teknologjitë digjitale më të frekuentuara nga nxënësit dhe këto teknologji a kanë ndërlidhje në mënyrë statike të rëndësishme, me kohën që kalojnë nxënësit në to?
- P3. A ekziston ndërlidhje mes varshmërisë të teknologjive digjitale dhe variablave socio-demografike: vendbanimi dhe mosha tek nxënësit ?
- P4. A ekziston ndërlidhje mes performancës akademike dhe variablave sociodemografike: vendbanimi dhe mosha tek nxënësit ?
- P5. A ekzistojnë diferenca gjinore në mënyrë statike të rëndësishme, në kontekst të varshmërisë nga teknologjitë digjitale ?
- P6. A ekzistojnë diferenca gjinore në mënyrë statike të rëndësishme, në kontekst të performancës akademike tek nxënësit?

2.2 Qëllimet e kërkimit, tezës

Qëllimi i këtij punimi është deskriptiv dhe prediktiv. Është deskriptiv sepse do behet përshkrimi i varshmërisë nga teknologjitë digjitale si dhe do të përshkruhen performanca akademike që vjen si pasojë e varshmërive nga teknologjitë digjitale tek nxënësit.

Është prediktiv, sepse synon të bëjë ndërlidhjen mes variablave hulumtuese varshmërisë nga teknologji digjitale dhe pasojat psikosociale siç janë vetmia, turpi, vetëvlerësimi dhe agresiviteti si dhe ndërlidhjen e këtyre variablave me karakteristikat socio-demografike me operacione të ndryshme të programeve statistikore.

Qëllimi tjetër i këtij studimi është të vërtetohet ndërlidhja në mes teknologjive digjitale që më së shumti frekuentohen nga nxënësit, si dhe devijimeve psiko-sociale. Po ashtu, të shqyrtojmë nëse ka diferenca gjinore në kontekst të performancës akademike, siç janë: vetmia, vetëvlerësimi, agresiviteti dhe turpi tek nxënësit.

2.3. Lënda e kërkimit

Të gjithë jemi dëshmitarë se sa të aftë janë nxënësit tanë për të përdorur lojërat elektronike, telefonat celularë nga më të sofistikuarit, kompjuterët dhe pajisje të tjera digjitale. Por akoma më të aftë janë ata që prodhojnë programe, lojëra për fëmijë, e reklama

apo produkte, të cilat shtojnë kuriozitetin dhe vullnetin e nxënësve për t'i njohur e përdorur ato më tej. Këto të reja teknologjike, natyrisht, që kanë një kosto për familjet tona, kosto këto që shpesh herë nuk janë vetëm ekonomike por janë edhe me pasoja më të rënda siç janë pasojat psiko-emocionale që vijnë nga përdorimi i tepër i teknologjive digjitale. Andaj lënda e hulumtimit tonë është t'i hulumtojmë varshmëritë që vijnë nga teknologjitë digjitale dhe pasojat që bartin ato tek nxënësit.

2.4. Hipotezat dhe qëndrimet hipotetike

- H1. Ekziston ndërlidhje mes variablave varshmëria nga teknologjitë digjitale dhe performancës akademike tek nxënësit.
- H2. Teknologjitë digjitale më të frekuentuara nga nxënësit janë telefonat mobil, *iPad*-at dhe laptopët dhe këto teknologji kanë ndërlidhje në mënyrë statike të rëndësishme, me kohen që kalojnë nxënësit në to.
- H3. Ekziston ndërlidhje mes varësisë të teknologjive digjitale dhe variablave socio-demografike: gjinia, mosha, vendbanimi tek nxënësit.
- H4. Ekziston ndërlidhje mes performancës akademike dhe variablave socio-demografike: gjinia, mosha, vendbanimi tek nxënësit.
- H5. Ekzistojnë diferenca gjinore në mënyrë statike të rëndësishme, në kontekst të varësisë nga teknologjitë digjitale.
- H6. Ekzistojnë diferenca gjinore në mënyrë statike të rëndësishme, në kontekst të performancës akademike: vetmia, vetëvlerësimi, agresiviteti dhe turpi tek nxënësit?

2.5. Metodatat dhe teknikat e kërkimit

Ky është një studim transversal, i cili me anë të metodës sasiore të grumbullimit të të dhënave, përshkruan dhe analizon varësin e internetit dhe të rrjeteve sociale nga nxënësit dhe performanca akademike që sjellin këto të fundit. Nëse qëllimi i një studimi është të kuptuarit e sjelljes njerëzore në këndvështrimin e asaj që përfshin në raport me mjedisin, metoda më e përshtatshme për t'u përdorur është ajo sasiore, (Plummer 2001). Mungesa e studimeve të mëparshme në këtë fushë rekomandon nga ana tjetër aplikimin e një metodologjie përgjithësuese. Përdorimi i saj na ndihmon të shpjegojmë ndikimin e botës virtuale në sjelljen

e nxënësve, duke u bazuar edhe në karakteristikat që paraqet kjo grup-moshë, si një nga sfidat më të rëndësishme jo vetëm për ta, por njëkohësisht për familjen, shkollën dhe komunitetin në përgjithësi. Nëse në këtë periudhë tranzicioni do t'iu ofronim nxënësve mbështetjen e duhur sociale për nxënësit do të krijohet mundësia e një përshtatjeje të suksesshme (Pratt., 2000).

2.6. Instrumentet e përdorura

. Për realizimin e hulumtimit tonë u përdorën dy instrumente matëse të cilët janë :

Instrumenti matës i varësisë nga teknologjitë digjitale - është një pyetësor i standardizuar nga Kimberly Young (1998). i cili përbëhet nga 20 pohime. Për çdo pohim, respondentit qarkonte njërin nga alternativat, Aspak nuk pajtohem, nuk pajtohem, ndonjëherë pajtohem, shpesh pajtohem, gjithmonë pajtohem. Këto alternativa ishin pikëzuar me pikët nga 1 deri te 5 dhe sa më shumë pikë që merrte respondentit, aq më i lartë ishte niveli i tij i varësisë nga interneti.

: ***Instrumenti matës i varshmërisë së performancës akademike*** - Ky pyetësor i përdorur në këtë studim është hartuar duke pasur parasysh se nxënësit janë të “uzurpuar” nga format e ndryshme të teknologjive digjitale, të tilla si kompjuterët dhe interneti. Në mënyrë të habitshme këto teknologji interaktive, kanë sjell një formë të re të ndërveprimit shoqëror. Kjo formë e re komunikimi, e cila ndodh përmes botës elektronike, është veçanërisht e popullarizuar tek kjo grupmoshë. Ky pyetësor është standardizuar nga Subrahmanyam & Greenfi në vitin 2008. Këto teknologji, jo vetëm që kanë ndikuar në komunikimin bashkëmoshatar, por ato gjithashtu kanë influencuar edhe në sjelljen e nxënësve në aktivitetet e tjera që ata kryejnë në lidhje me kalimin e kohës së lirë dhe ndërveprimin me familjen. Shikuar nga ky këndvështrim, ky pyetësor e ka konsideruar botën digjitale si një kontekst të rëndësishëm shoqëror në zhvillimin e nxënësve dhe sjelljen e tyre në raport me familjen, shokët/shoqet, shkollën dhe komunitetin.

Pyetësori përbëhet nga 15 pyetje, të tipit të mbyllur me 5 shkallë vlerësuese të cilat përshkruajnë, matin dhe i vlerësojnë performancat akademike të nxënësve.

Tabela 1. Koeficientet e besueshmërisë për testimin e varshmërisë nga teknologjitë digjitale

Nr. i ajetemve	Cronbach's Alpha	Lambda				
		1	2	3	4	5
20	0.001	0.001	0.153.	0.001	0.208	0.108

Nga rezultatet e paraqitura në tabelën e mësipërme, mund të shohim se instrumenti matës i cili mat varëshmërinë nga teknologjitë digjitale, nuk plotëson kushtin e rëndësishëm për aplikim të instrumentit matës, respektivisht vlerat e besueshmërisë për metodën Alfa e Kronbahut Alfa=0.001 dhe Gutman = 0.75 nuk arrijnë vlerat e besueshmërisë $\alpha=0.80$.

Tabela 2. Koeficientet e besueshmërisë për testimin e performancës akademike tek nxënësit

Nr. i ajetemve	Cronbach's Alpha	Lambda					
		1	2	3	4	5	6
15	0.061	0.055	0.198.	0.061	0.284	0.220	0.285

Nga rezultatet e paraqitura në tabelën e mësipërme mund të shohim se instrumenti matës i cili mat devijimet psiko-sociale tek adoleshentët nuk kënaqë kushtin e rëndësishëm për aplikim të instrumentit matës, respektivisht vlerat e besueshmërisë për metodën Alfa e Kronbahut Alfa=0.061 dhe Gutman = 0.75, nuk arrijnë vlerat e besueshmërisë $\alpha=0.80$.

2.7. Popullacioni dhe mostra

Përzgjedhja e pjesëmarrësve në studim, u krye nëpërmjet kampionit të stratifikuar, duke zvogëluar popullatën e studimit nga një masë e madhe dhe heterogjene nxënësish, në

shkollat ku kemi aplikuar instrumentin tek 200 nxënës gjithsej. 50 nxënës ishin të Sh.f. "Ismail Qemali", 50 nxënës nga Sh.f. "Emin Duraku", 50 nxënës ishin nga Sh.m "Iliria" dhe 50 nxënës të tjerë Sh.m. "Elene Gjika". Nxënësit e anketuar vijonin nga klasa e IX deri në klasën e XII, dhe të cilët ishin nga moshën 15 deri 18 vjet. 100 nxënës ishin të gjinisë mashkullore dhe 100 të tjerë të gjinisë femërore.

Tabela 3. Paraqitja tabelore e shkollave në të cilat kemi marr nxënësit si mostër për studim

Shkolla	Frekuencat	Përqindja
Ismail Qemali	50	25%
Emin Duraku	50	25%
Iliria	50	25%
Elena Gjika	50	25%
Total	200	100.0%

Shkollat - Tabela 3 na tregon se në studim gjithsej morën pjesë 200 nxënës të cilët vijojnë mësimin në 4 shkolla të mesme të ulëta në qytetin e Prishtinës. 50 nxënës ishin të Sh.f. "Ismail Qemali", 50 nxënës nga Sh.f. "Emin Duraku", 50 nxënës ishin nga Sh.m "Iliria" dhe 50 nxënës të tjerë Sh.m. "Elena Gjika".

Tabela 4. Paraqitja tabelore e gjinisë së nxënësve të përfshirë në studim si dhe përqindja relative e tyre

Gjinia	Frekuencat	Përqindja
Mashkull	101	100%
Femër	99	100%
Total	200	100.0%

Gjinia - tabela 4 na tregon se gjithsej në studim morën pjesë 200 nxënës, ku prej tyre në 49%, ishin të gjinisë femërore dhe 51% të gjinisë mashkullore. Pra këtu shohim se nuk kemi ndonjë dominim të madh të ndonjë gjinie.

Tabela 5. Paraqitja tabelore e moshës së adoleshentëve të përfshirë në studim

Mosha	Frekuencat	Përqindja
15 vjeç	68	34%
16 vjeç	112	56%
17-18 vjeç	20	10%
Total	200	100.0%

Mosha e nxënësve - tabela 5 na tregon se kemi nxënës të moshave të ndryshme, të përfshirë në këtë studim, që numri i tyre arrin 68 adoleshentë, apo 34% ishin nga mosha 15 vjeç, 112 nxënës apo 56% i përkisnin moshës nga 16 vjeç, dhe 20 apo 10% nxënës ishin 17-18vjeç.

2.8 Qëndrueshmëria dhe vlefshmëria e pyetësorëve

Vlefshmëria e pyetësorëve është një nga gjërat më të rëndësishme që shtyn më pas të besohen dhe rezultatet që dalin nga analiza e të dhënave. *Alpha Cronbach* nëpërmjet koeficientit që na jep tregon se, sa një instrument mat atë që duhet të masë, sa i besueshëm është një instrument për të dhënat që ne na interesojnë të mbledhim dhe sa i vlefshëm është ai. Vlefshmëria, ka të bëjë me faktin nëse pohimet e përdorura gjatë shkallës, masin atë që kërkojmë për të matur. Ajo shihet nëpërmjet korrelacioneve dhe të pohimeve me shkallën përkatëse, dhe gjithashtu përmes llogaritjes me koeficientet e *Alpha Cronbach*. Kur flasim për qëndrueshmërinë e një testi, duam të vëmë në dukje nëse në të njëjtat kushte dhe rrethana, rezultatet e marra nga shkalla do të jenë të njëjta ose pothuajse të tilla. Për këtë mund të përdoret metoda e testimit/ritestimit apo përdorimi i një instrumenti i cili mat të njëjtën dukuri, për të parë kështu qëndrueshmërinë e brendshme.

2.8.1 Organizmi dhe rrjedhja e studimit

Fillimisht është marr leja nga Ministria e Arsimit për aplikimin e pyetësorit në 5 shkollat e cekura në këtë studim, pastaj në diskutim me drejtorët shkollave është caktuar koha dhe vendi i aplikimit të pyetësorit, në atë mënyrë që mos t'i pengojmë nxënësit dhe

mësimdhënësit në procesin mësimor. Fillimisht pyetëtorët u janë shpërndarë subjekteve pjesëmarrës në hulumtim dhe pastaj i janë dhënë udhëzimet e nevojshme nga vetë hulumtuesi. Pyetëtori është plotësuar brenda 5 dite, varësisht se kur kanë qenë të lirë subjektet për realizimin pyetësorit. Aplikimi i pyetësorit ka shkuar shumë mirë dhe nuk ka pasur ndonjë ndikim apo paqartësi nga ana e subjekteve të anketuar. Subjektet janë përzgjedhur me anë të metodës së rastësisë.

2.8.2 Përpunimi i statistikave

Pas përfundimit të mbledhjes së të dhënave, u krijua data-baza me të dhënat e mbledhura si dhe përpunimi dhe analiza e tyre. Në përputhje me natyrën e tij përshkuese dhe korrelacionale, ku të dhënat e këtij studimi janë analizuar nëpërmjet paketave të programeve statistikore IBM SPSS versioni 20 dhe programit kompjuterik Microsoft Office Excel 2007. Tipi i analizës së aplikuar në këtë studim ka ndjekur këto hapa: Analiza deskriptive u përdor me qëllim organizimin dhe përmbledhjen e të dhënave të të gjithë nxënësve nëpërmjet përllogaritjes së moshës, gjinisë etj. Kjo analizë shpreh karakteristikat e të gjithë popullatës duke qenë se kampioni i përzgjedhur ishte përfaqësues. Analiza përshkuese është kryer, gjithashtu, për të evidentuar nivelin e aktivitetit fizik, kohën e kushtuar në përdorimin e Internetit, si dhe funksionin më të preferuar për ata. Përveç statistikës përshkuese, në këtë studim janë përdorur analizat korrelacionale, për të përcaktuar marrëdhënien midis nivelit të performancës akademike dhe varësisë ndaj Internetit. Analizat korrelacionale janë përdorur gjithashtu, për përcaktuar marrëdhëniet midis gjinisë, moshës.

2.8.3 Struktura e punimit të tezës, kaptinat, pjesa teorike, elementet empirike

Kapitulli i parë, fokusohet në shqyrtimin e literaturës në lidhje me fenomenin e varësisë ngainterneti në botë dhe në vendin tonë, duke iu referuar të gjitha kërkimeve akademike të realizuara në këtë drejtim. Pse bëhen individët të varur nga interneti? Cilët janë faktorët që ndikojnë në varësinë nga interneti dhe duke u fokusuar në mënyrë të detajuar në studimet e realizuara në lidhje me marrëdhënien që ekziston ndërmjet varësisë nga interneti dhe performancës akademike etj

Kapitulli i dytë, pasqyron metodologjinë e përdorur në këtë studim. Në këtë kapitull përfshihen çështje që kanë të bëjnë me përshkrimin e situatës, përcaktimin e problemit, qëllimin e studimit, paraqitjen e objektivave dhe pyetjeve kërkimore të studimit,

rëndësinë që ka përshkruhet metoda e studimit, popullata, zgjedhja e kampionit, procedura, instrumentet e përdorur për realizimin e studimit, besueshmëria e tyre si dhe analiza e të dhënave.

Në kapitullin e tretë, paraqitet një analizë e detajuar e gjetjeve të studimit, duke u ndërthurur me analizën e literaturës së shqyrtuar në kapitullin e dytë dhe duke iu referuar të gjitha studimeve të autorëve vendas dhe të huaj që kanë shkruar mbi fenomenin e varësisë nga interneti. Gjithashtu.

Në kapitullonin e katërt, përfshihen diskutimet dhe rekomandimet për studime të mëtejshme në këtë fushë. Në fund, paraqiten referencat dhe shtojcat ku përfshihen të gjithë instrumentet e përdorur përmbledhjen e të dhënave .

2.8.4 Kufizimet e studimit

Kufizimet e studimit tone janë:

- Duke qenë se janë përdorur pyetësorë me vetë-raportim, duhet të kemi parasysh edhe masën e sinqeritetit në dhënien e përgjigjeve.
- Pyetësorët u plotësuan në klasë, dhe në këtë mënyrë ka qenë i pashmangshëm ndikimi i nxënësve nga njëri-tjetri në dhënien e përgjigjeve.
- Duhet të merret në konsideratë lodhja e nxënësve gjatë plotësimit të pyetësorit. Meqenëse pyetësori përmbante një numër të konsiderueshëm pohimesh, një gjë e tillë mund të ketë interferuar në përgjigjet e tyre.
- Njëkohësisht si kufizim tjetër mund të konsiderohet fakti i mungesës së studimeve të mëparshme lidhur me këtë temë, kjo sepse në Kosovë vetëm këto vitet e fundit teknologjia dhe interneti kanë pasur më shumë zhvillim.

2.8.5 Konsiderata etike e studimit

Ka një numër parimesh etike që duhet të merren në konsideratë kur realizohet një studim. Në thelb, këto parime etike theksojnë nevojën për të bërë më të mirën dhe njëkohësisht për të mos shkaktuar asnjë dëm. Këto parime etike të sjellin në vëmendje faktin se studiuesi/ja duhet të:

- a) marrë pëlqimin e informuar nga pjesëmarrësit e kërkimit,

- b) minimizojë rrezikun e dëmtimit të pjesëmarrësve;
- c) mbrojtë anonimitetin dhe konfidencialitetin e pjesëmarrësve;
- d) shmang përdorimin e praktikave mashtruese
- e) t'iu jap pjesëmarrësve të drejtë të tërhiqen nga kërkimin, nëse dëshirojnë ta bëjnë një veprim të tillë.

Respektimi i këtyre parimeve etike, u bë një nga çështjet më të rëndësishme të këtij studimi dhe përfshiu të gjitha subjektet që morën pjesë në këtë studim. Qartësimi i qëllimit të studimit, ishte një ndër elementet kryesore të studimit, i cili u bë me qëllim për shmangien e keqinterpretimeve, që mund të lindnin si pasojë e çështjes së marr në analizë, për të cilën të gjitha subjektet shprehën qëndrimin personal.

III. REZULTATET E STUDIMIT

Në këtë pjesë të punimit do t'i paraqesim rezultatet e arritura përgjatë këtij hulumtimi. Për prezantim sa më të qartë dhe sa më logjik të rezultateve nga analizat e bëra statistikore, të dhënat do t'i prezantojmë në formë të tabelave.

3.1. Rezultatet lidhur me shpërndarjen e variablave

Në vazhdim, do të paraqesim rezultatet lidhur me hipotezat, në të cilat ngërthehet kërkesa për të testuar dallimin mes respondentëve, në kontekst të variablave hulumtuese.

Tabela 6. Mesatarja dhe devijimi standard i nivelit të përgjithshëm të variablave.

Variablat	Numri (N)	Minimum	Maksimum	Mesatarja (M)	Devijimi standard (DS)
Varshmëria nga teknologjitë digjitale	200	2.15	3.30	2.66	0.213
Performanca akademike	200	1.20	2.30	1.67	0.248

Variablat e varshmërisë nga teknologjitë digjitale, dhe performanca akademike tek nxënësit, janë matur me dy instrumente të tipit me përgjigje të mbyllur.

- Minimizimi rezultatit për secilin respondent, në shkallën e përgjithshme për vlerësimin e varshmërisë nga teknologjitë digjitale ishte 2.15, maksimumi 3.30, mesatarja $M=2.66$, dhe $DS=0.21$
- Minimizimi i rezultatit për secilin respondent, në nën-shkallën për vlerësimin e performancës akademike ishte 1.20, maksimumi 2.30, mesatarja $M=1.67$ dhe $DS=0.24$.

3.2. Rezultatet lidhur me korrelacionet

Qëllimi i këtij kreu është interpretimi dhe analiza e korrelacioneve të përdorura në realizimin e këtij studimi. Në këtë kapitull, do të analizojmë korrelacionin në mes varshmërisë digjitale dhe performancës akademike tek nxënësit si dhe ndërlidhjen me variablat socio-demografike: gjinia dhe mosha kalendarike e nxënësve.

Në saje të metodologji u parashtrua pyetja kërkimore a ekziston ndërlidhjen mes varshmërisë nga teknologjitë digjitale dhe perfemoncës akademike tek nxënësit?

Në hipotezën **H1**, është shprehur pohimi mbi ekzistimin ndërlidhjes në mes varshmërisë nga teknologjitë digjitale dhe performancës akademike tek nxënësit.

Tabela 7. Korrelacioni në mes varshmërive nga teknologjitë digjitale dhe performancës akademike tek nxënësit

		Varëshmëria nga teknologjit digjitale	Performanca akademike
Varëshmëria nga teknologjit digjitale	Pearson	1	0 .083 **
	Correlation		
	Sig. (2-tailed)		242
	N	200	200
Performanca akademike	Pearson	0.083 **	1
	Correlation		
	Sig. (2-tailed)	242	
	N	200	200


Nga analiza korrelative nxjerrim këto përfundime:

- Varshmëria nga teknologjitë digjitale ka korrelacion shumë të dobët pozitiv me performanca akademike tek nxënësit $r=0.083$: $p>0.01$ në nivelin e rëndësisë 0.01. Por që nuk ka lidhje sinjifikative në mes tyre

Nga evidenca që na jep analiza statistikore korrelative, mund të përfundojmë se ka lidhshmëri shumë të dobët pozitive, në mes varshmërisë nga teknologjitë digjitale, dhe performancës akademike tek nxënësit, por që kjo lidhje nuk është sinjifikative. Nga këto rezultate mund të përfundojmë se e pranojmë hipotezën e parë.

Në saje të metodologjisë kërkimore, u parashtrua pyetja cilat janë teknologjitë digjitale më të frekuentuara nga nxënësit, dhe këto teknologji a kanë ndërlidhje në mënyrë statike të rëndësishme me kohën që kalojnë nxënësit në to ?

Në hipotezën **H2**, është prezantuar pohimi me të cilin shprehet se teknologjitë digjitale më të frekuentuara nga nxënësit, janë telefonat mobil, ipad-tat dhe laptopët, dhe këto teknologji kanë ndërlidhje në mënyrë statike s të rëndësishme me kohën që kalojnë nxënësit në to.



Grafikoni 1. Teknologjitë digjitale më të frekuentuara nga nxënësit

Nga grafikoni 1 kuptojmë se nxënësit i përdorin në masë mjaft të madhe teknologjitë digjitale. Nga rezultatet kuptojmë se 82% nxënësve të anketuar e përdorin telefonin, 3% e nxënësve e përdorin iPad-in, 8% e përdorin laptopin ose kompjuterin, 7% plastalion-in dhe 1% përdorin tjera aparate digjitale.

Tabela 8. Korrelacioni në mes varshmërive nga teknologjitë digjitale, dhe kohës së kaluar në aparatet digjitale

		Varëshmëria nga teknologjitë digjitale	Koha e kaluar në teknologjitë digjitale
Varëshmëria nga teknologjitë digjitale	Pearson	1	-0.192**
	Correlation		
	Sig. (2-tailed)		.007
	N	200	200
Koha e kaluar në teknologjitë digjitale	Pearson	-0.192**	1
	Correlation		
	Sig. (2-tailed)	.007	
	N	200	200

Nga analiza korrelative nxjerrim këto përfundime:

- ▶ Varshmëria nga teknologjitë digjitale ka korrelacion shumë të dobët negativ me kohën e kaluar në teknologjitë digjitale $r = -0.192$; $p > 0.01$, në nivelin e rëndësisë 0.01. Sa më tepër të kalojnë kohë nxënësit teknologjitë digjitale, aq më shumë rritet rreziku për varshmëri nga teknologjitë digjitale.

Nga evidenca që na jep analiza statistikore korrelative, mund të përfundojmë se ka lidhshmëri shumë të dobët negative, në mes varshmërisë nga teknologjitë digjitale dhe kohës së kaluar në teknologjitë digjitale, por që kjo lidhje nuk është sinjifikative. Nga këto rezultate mund të përfundojmë se, nuk e pranojmë hipotezën e dytë.

Në sajë të metodologjisë kërkimore, u parashtrua pyetja të cilat pohojnë se, a ekziston ndërlidhje mes teknologjive digjitale dhe variablae socidemografike: gjinia, mosha, vendbanimi tek nxënësit ?

Në hipotezën **H3**, është prezantuar pohimi, me të cilin shprehet ajo mbi ekzistimin e ndërlidhjes mes përdorimit të teknologjive digjitale dhe variablae socidemografike: gjinia, mosha, vendbanimi tek nxënësit.

Tabela 9. Korrelacioni në mes varshmërisë nga teknologjitë digjitale dhe gjinisë së nxënësve

		Varshmëria e teknologjive digjitale	Gjinia
Varshmëria e teknologjive digjitale	Pearson	1	-0.012**
	Correlation		
	Sig. (2-tailed)		.862
	N	200	200
Gjinia	Pearson	-0.12**	1
	Correlation		
	Sig. (2-tailed)	.862	
	N	200	200

Nga analiza korrelative nxjerrim këto përfundime:

- Përdorimi i teknologjive digjitale ka korrelacion shumë të dobët negativ, me gjininë e nxënësve $r = -0.012$; $p > 0.01$, në nivelin e rëndësisë 0.01.

Nga evidenca që na jep analiza statistikore korrelative, mund të përfundojmë se ka lidhshmëri shumë të dobët negative mes përdorimit të teknologjive digjitale, dhe gjinisë së nxënësve, por që kjo lidhje nuk është sinjifikative.

Tabela 10. Korrelacioni në mes varshmërisë nga teknologjitë digjitale dhe moshës së nxënësve

		Varshmëria e teknologjive digjitale	Mosha
Varshmëria e teknologjive digjitale	Pearson	1	0.070 .
	Correlation		
	Sig. (2-tailed)		322
	N	200	200
Mosha	Pearson	0.070	1
	Correlation		
	Sig. (2-tailed)	322	
	N	200	200

Nga analiza korrelative nxjerrim këto përfundime:

- ▶ Varshmëria nga teknologjitë digjitale ka korrelacion shumë të dobët pozitiv, me moshën e nxënësve $r = 0.70$; $p > 0.01$, në nivelin e rëndësisë 0.01.

Nga evidenca që na jep analiza statistikore korrelative, mund të përfundojmë se ka lidhshmëri të shumë të dobët pozitive mes përdorimit të teknologjive digjitale, dhe moshës së nxënësve, por kjo lidhje nuk është sinjifikative.

Tabela 11. Korrelacioni në mes varshmërisë nga teknologjitë digjitale dhe vendbanimit të nxënësve

		Varshmëria e teknologjive digjitale	Vendëbanimi
Varshmëria e teknologjive digjitale	Pearson	1	0.095 .
	Correlation		
	Sig. (2-tailed)		125
	N	200	200
Vendëbanimi	Pearson	0.095	1
	Correlation		
	Sig. (2-tailed)	125	
	N	200	200

Nga analiza korrelative nxjerrim këto përfundime:

- ▶ Varshmëria nga teknologjitë digjitale ka korrelacion shumë të dobët pozitiv, me vendbanimin e nxënësve $r = 0.95$; $p > 0.01$, në nivelin e rëndësisë 0.01.

Nga evidenca që na jep analiza statistikore korrelative, mund të përfundojmë se ka lidhshmëri të shumë të dobët pozitive mes përdorimit të teknologjive digjitale, dhe vendbanimit të nxënësve, por kjo lidhje nuk është sinjifikative. Nga këto rezultate mund të përfundojmë se nuk pranojmë hipotezën e katërt.

Tabela 12. Korrelacioni në mes performancës akademike dhe gjinisë së nxënësve

		Performanca akademike	Gjinia
Performanca akademike	Pearson	1	0.066 **
	Correlation		
	Sig. (2-tailed)		357
	N	200	200
Gjinia	Pearson	0.066 **	1
	Correlation		
	Sig. (2-tailed)	357	
	N	200	200

Nga analiza korrelative nxjerrim këto përfundime:

- ▶ Performanca akademike ka korrelacion shumë të dobët pozitiv, me gjininë e nxënësve $r = 0.066$; $p > 0.01$, në nivelin e rëndësisë 0.01.

Nga evidenca që na jep analiza statistikore korrelative, mund të përfundojmë se ka lidhshmëri shumë të dobët pozitive performancës akademike digjitale, dhe gjinisë së nxënësve, por që kjo lidhje nuk është sinjifikative.

Tabela 13. Korrelacioni në mes performancës akademike dhe moshës së nxënësve

		Performanca akademike	Mosha
Performanca akademike	Pearson	1	0.041 **
	Correlation		
	Sig. (2-tailed)		567
	N	200	200
Mosha	Pearson	0.041 **	1
	Correlation		
	Sig. (2-tailed)	567	
	N	200	200

Nga analiza korrelative nxjerrim këto përfundime:

- ▶ Performanca akademike kanë korrelacion shumë të dobët pozitiv, me moshën e nxënësve $r = 0.041$; $p > 0.01$, në nivelin e rëndësisë 0.01.

Nga evidenca që na jep analiza statistikore korrelative, mund të përfundojmë se ka lidhshmëri të negative mes përdorimit të teknologjive digjitale, dhe moshës së nxënësve, por që nuk ka lidhje sinjifikative.

Tabela 14. Korrelacioni në mes performancës akademike dhe vendbanimit të nxënësve

		Performanca akademike	Vendëbanimi
Performanca akademike	Pearson	1	0.071 .**
	Correlation		
	Sig. (2-tailed)		254
	N	200	200
Vendëbanimi	Pearson	0.041 **	1
	Correlation		
	Sig. (2-tailed)	254	
	N	200	200

Nga analiza korrelative nxjerrim këto përfundime:

- ▶ Performanca akademike kanë korrelacion shumë të dobët pozitiv, me vendbanimin e nxënësve $r = 0.071$: $p > 0.01$, në nivelin e rëndësisë 0.01.

Nga evidenca që na jep analiza statistikore korrelative ,mund të përfundojmë se ka lidhshmëri negative mes përdorimit të teknologjive digjitale, dhe vendbanimit të nxënësve, por që nuk ka lidhje sinjifikative. Nga këto rezultate mund të përfundojmë se nuk pranojmë hipotezën e pestë.

Ekzistojnë diferenca gjinore në mënyrë statistike të rëndësishme, në kontekst të performancës akademike: vetmia, vetëvlerësimi, agresiviteti dhe turpi tek nxënësit

Në sajë të metodologjisë kërkimore u parashtrua pyetja a ekzistojnë diferenca gjinore në mënyrë statike të rëndësishme, në kontekst të varshmërisë nga teknologjitë digjitale ?

Në hipotezën **H5**, është prezantuar pohimi me të cilin shprehet ekzistimi i diferencave gjinore në mënyrë statike të rëndësishme, në kontekst të varshmërisë nga teknologjitë digjitale.

Ekzistojnë diferenca gjinore në mënyrë statike të rëndësishme, në kontekst të performancës akademike: vetmia, vetëvlerësimi, agresiviteti dhe turpi tek nxënësit

Tabela 15. Paraqitja tabelore e dallimeve gjinore në kontekst të varshmërisë nga teknologjitë digjitale

Variabla	Gjinia	Numri i rasteve (N)	Mesatarja (M)	Devijimi standard (DS)	Mesatarja e gabimit standard
Varësia nga teknologjitë digjitale	Meshkuj	101	2.6662	0.21054	0.2116
	Femra	99	2.6609	0.21640	0.2153

Duke i vështuar mesataret që arrijnë meshkujt dhe femrat në tabelën 15, shohim se femrat arrijnë mesatare më të lartë (2.666) se sa meshkujt (2.660). Devijimi standard për meshkujt është $Ds=0.210$, ndërsa për femrat $Ds=0.216$, dhe mesatarja e gabimit standard për gjininë mashkullore është 0.211, dhe për gjininë femërore 0.215. $P>0.05$.

Nga evidenca që na jep analiza statistikore në tabelën 15, mund të përfundojmë se nuk ekzistojnë diferenca të rëndësishme gjinore në kontekstet të varshmërisë nga teknologjitë digjitale. Nga kjo mund të përfundojmë se nuk e pranojmë hipotezën e pestë.

Në sajë të metodologjisë, kërkimore u parashtrua pyetja, a ekzistojnë diferenca gjinore në mënyrë statike të rëndësishme, në kontekst të performancës akademike : vetmia, vetëvlerësimi, tek nxënësit?

Në hipotezën **H6**, është prezantuar pohimi me të cilin shprehet ekzistimi i diferencave gjinore në mënyrë statike të rëndësishme, në kontekst të performancës akademike tek nxënësit.

Tabela 16. Paraqitja tabelore e dallimeve gjinore në kontekst të performancës akademike

Variabla	Gjinia	Numri i rasteve (N)	Mesatarja (M)	Devijimi standard (DS)	Mesatarja e gabimit standard
Performanca akademike	Meshkuj	101	1.6921	0.25404	0.2528
	Femra	99	1.6596	0.24282	0.2440

Duke i vështuar mesataret që arrijnë meshkujt dhe femrat në tabelën 16, shohim se femrat arrijnë mesatare më të ulët (1.69), se sa meshkujt (1.65). Devijimi standard për meshkujt është $Ds=0.25$, ndërsa për femrat $Ds=0.24$, dhe mesatarja e gabimit standard për gjininë mashkullore është 0.25 dhe për gjininë femërore 0.24. $P>0.05$

Nga evidenca qe na jep analiza statistikore në tabelën 16, mund të përfundojmë se nuk ekzistojnë diferenca të rëndësishme gjinore, në kontekstet të pasojave psiko-sociale. Nga kjo mund të përfundojmë se nuk e pranojmë hipotezën e gjashtë.

IV. DISKTUIMI I REZULTATEVE

Në këtë kapitull, janë përmbledhur gjetjet kryesore të studimit, duke i diskutuar ato në lidhje me literaturën përkatëse. Këto gjetje janë krahasuar me studime të tjera nga autorë të ndryshëm, dhe është paraqitur këndvështrimi lidhur me to në kontekstin shqiptar, ku është kryer edhe ky studim. Fokusi i këtij studimi është të paraqes rezultatet lidhur me varshmëritë nga teknologjitë digjitale dhe performancës akademike tek nxënësit (të lidhura këto dhe me të dhëna demografike).

Ky studim, përmban marrëdhënie korrelacionale ndërmjet ndryshoreve të marra në studimin e varshmërisë nga teknologjitë digjitale, dhe performancës akademike tek nxënësit. Aplikimi i pyetësorëve solli të dhëna, të cilat u analizuan duke u dhënë përgjigje objektive dhe pyetjeve kërkimore të mirëpërcaktuara për fokus të studimit. Më poshtë do të jepen gjetjet kryesore të studimit duke i ilustruar ato edhe me studime të tjera.

Shkallët matëse të përdorura në këtë studim, u testuan për besueshmërinë e tyre. Edhe pse nuk është qëllim i këtij studimi të standardizojë shkallët matëse, vëmendje e veçantë iu kushtua analizës së besueshmërisë me qëllim që instrumentet të siguronin cilësi në mbledhjen e të dhëna sasiore dhe që do të shërbenin më tej për t'u përpunuar nëpërmjet analizave statistikore. Kështu, u testua alfa e Cronbach'ut dhe modeli Gutman. Nga rezultatet e paraqitura, shohim se instrumenti matës i cili mat varësin nga teknologjitë digjitale kënaqë kushtin e rëndësishëm për aplikim të instrumentit matës, respektivisht vlerat e besueshmërisë për metodën Alfa e Kronbahut Alfa=0.825 dhe Gutman = 0.75, arrijnë vlerat e besueshmërisë $\alpha=0.80$. Instrumenti matës i cili mat performancën akademike tek nxënësit, pjesërisht plotëson kushtin e rëndësishëm për aplikim të instrumentit matës, respektivisht vlerat e besueshmërisë për metodën Alfa e Kronbahut Alfa=0.75 dhe Gutman = 0.75 nuk arrijnë vlerat e besueshmërisë $\alpha=0.80$.

Diskutime për pyetjen kërkimore: 1. A ekziston ndërlidhje mes variablave të varshmërisë nga teknologjitë digjitale me perofmancës akademike tek nxënësit ?

Në dekadën e fundit ndikimi i teknologjisë është bërë i pashmangshëm. Shpejtësia e përhapjes së tij e ka bërë pjesë të pandarë të jetës së nxënësve. Teknologjitë teknologjike të reja, jo vetëm që janë bërë një mjet i rëndësishëm që lidhin nxënësit me shokët e tyre (Subrahmanyam & Greenfi, 2008), por ndikimi i tyre po reflektohet në mënyrën e zhvillimit dhe të sjelljes në adoleshencë. Në fakt, Greenfi & Yan (2006) i referohen telefonit mobil si

një mjet kulturor, i përbërë nga një seri e pafundme aplikacionesh. Mjediset online janë hapësira kulturore, ku normat janë krijuar në mënyrë të përbashkët dhe janë transmetuar tek përdoruesit. Kultura online nuk është statike, por është një entitet dinamiko-ciklik, dhe përdoruesit janë vazhdimisht në gjenerimin, duke kaluar në norma të reja.

Arsimi dhe pedagogjia në mënyrë të përditshme janë aktorë aktivë në një projekt impenjativ për t'u përfshirë në shkallën më të lartë dhe në nivele të ndryshme, të formimit të njeriut, dhe që vihen në funksion për ta edukuar atë me vetëdijen, ndërgjegjen dhe përgjegjësinë, gjë të cilën, asnjë libër pedagogjie mund ta ofrojë i vetëm.

Disa reflektime pedagogjike të kësaj natyre, e gjejnë zanafillën që në periudhën e Platonit, tek i cili në librin e tretë të *Republikës*, ku shumë shekuj më parë, identifikohen njohuri aktuale dhe pedagogjike jashtëzakonisht bashkëkohore dhe të dobishme edhe në ditët e sotme. Jo vetëm mësuesit profesionist edukojnë – pohon filozofi – por edhe “kudo-ja” (pantakhù), edukon apo disedukon.

Nga rezultatet e studimit tonë lidhur me pyetjen a e ekziston ndërlidhje mes variablave varshmëria nga teknologjitë digjitale me performancën akademike tek nxënësit kemi këto rezultate:

Varshmëria nga teknologjitë digjitale ka korrelacion shumë të dobët pozitiv me performancën akademike tek nxënësit

Arsyeja se përse kemi korrelacion të tillë është sepse nxënësit përdorin në masë të madhe teknologjitë digjitale gjithashtu edhe shumë pasoja psikosociale janë prezentë tek ata andaj duke u bazuar në rezultatet e studimit tonë themi sa më tepër ti përdorin nxënësit teknologjitë digjitale aq më shumë rritet rreziku për performancë të dobët akademike tek ata.

Diskutime për pyetjen kërkimore: 2. Cilat janë teknologjitë digjitale më të frekuentuara nga nxënësit dhe këto teknologji a kanë ndërlidhje statistikisht të rëndësishme me kohen që kalojnë nxënësit në to ?

Midis teknologjive digjitale të pafundme, adoleshentët parapëlqejnë teknologjitë digjitale ku ka mundësi chat-imi, të përdorin facebook-un, etj, për shumë arsye dhe e përdorin atë në mënyrë të tepruar. Ata ndihen të tërhequr nga njohjet e reja, bisedat, imazhet, sidomos nëse ato janë të lëvizshme dhe me ngjyra(Kuss, 2013). Të gjendur përpara shenjave ikonografike ata mendojnë se e kuptojnë plotësisht domethënien, pa përpjekje të dukshme, ndërsa shpesh luftojnë për të deshifruar një mesazh verbal, sidomos nëse ai është i shtypur. Nga ana tjetër gatishmëria e plotë e një ose disa individëve për të përdorur kompjuterin e bën më të lehtë përdorimin e internetit, ndërsa shumëllojshmëria e faqeve e ueb-ve dhe orët e shumta të

qëndrimit përpara teknologjive digjitale, mundësojnë një larmi të madhe zgjedhjesh; mungesa e vëllezërve dhe mungesa e bashkëmoshatarëve, puna e prindërve jashtë shtëpisë, vështirësia e të argëtuarit në natyrë i nxisin adoleshentët që të gjejnë tek teknologjitë digjitale një “zëvendësues” të rehatshëm dhe të dobishëm. Arsytet e përdorimit të vazhdueshëm të ekranit të vogël të teknologjive digjitale, shpesh në kufijtë e pasionit dhe të “varësisë”, duhen gjetur edhe tek prindërit.

Nga grafikoni 1 kuptojmë se nxënësit i përdorin në masë mjaft të madhe teknologjitë digjitale. Nga rezultatet kuptojmë se 82% nxënësve të anketuar e përdorin telefonin, 3% e nxënësve e përdorin ipad-in, 8% e përdorin laptopin ose kompjuterin, 7% përdorin tabletin dhe 1% përdorin tjera aparate digjitale. Kurse sa i përket pyetjes këto teknologji digjitale a kanë ndërlidhje statistikisht të rëndësishme me kohën që kalojnë nxënësit në to nxjerrim këto përfundime: varshmëria nga teknologjitë digjitale ka korrelacion shumë të dobët negativ me kohën e kaluar në teknologjitë digjitale. Sa më tepër të kalojnë kohë nxënësit teknologjitë digjitale aq më shumë rritet rreziku për varshmëritë nga teknologjitë digjitale. Arsyeja se pse kemi lidhshmëri të tillë ndërmjet teknologjive digjitale dhe kohës së kaluar në teknologjitë digjitale është sepse, shumica e nxënësve të cilët kanë kaluar kohë të gjatë në teknologji digjitale janë paraqitur tek ta shenja të varësisë nga teknologjitë digjitale andaj nga këto rezultate arrijmë në përfundim se sa më tepër kohe të kalojnë kohë nxënësit teknologjitë digjitale aq më shumë rritet rreziku për varshmëritë nga teknologjitë digjitale.

Diskutime për pyetjen kërkimore: 3. A ekziston ndërlidhje mes përdorimit të teknologjive digjitale dhe variablave sociodemografike: gjinia, mosha dhe vendbanimi tek nxënësit ?

Nisur nga fakti se, koha që kemi në dispozicion është e kufizuar, koha e kaluar në teknologjitë digjitale ndikon në realizimin e aktiviteteve të tjera (Nie & Hillygus, 2002). Studimet e (Kiesler, Mukopadhyay & Scherlis 1998, Mesch 2003, Nie, Hillygus & Erbring 2002) zbuluan se ndërveprimi social është një nga aktivitetet më të vlefshme të adoleshencës, i cili është zëvendësuar me përdorimin e teknologjive digjitale. Kjo ka çuar në kufizimin e aktiviteteve sportive, ndërveprimi me bashkëmoshatarët, familjarët pra, me botën e vërtetë në një komunikim ballë-për ballë, i cili ka avantazhet e veta për sa i përket mënyrës së komunikimit që përfshin shikimin, gjestet, gjuhën e trupit etj. Nga studimi i (Kraut, 1998) rezultoi se përdorimi i tepruar i internetit shoqërohet me reduktim të komunikimit në familje si dhe zvogëlim të rrethit shoqëror lokal, njëkohësisht me rritje të vetmisë dhe depresionit. Nie, (2002) gjithashtu theksoi se përdorimi i teknologjive digjitale ndikon në zhvendosjen e

kohës shoqërore. Bazuar në të dhënat e kohës ditore ata gjetën se përdorimi i tepruar i internetit është i lidhur me kufizimin e kohës kushtuar familjes dhe shoqërisë.

Nga rezultatet e studimit tonë dalim në përfundim se përdorimi i teknologjive digjitale ka korrelacion të negativ me gjininë e nxënësve.

Përdorimi i teknologjive digjitale ka korrelacion të shumë dobët pozitiv, me moshën e nxënësve

Nga evidenca që na jep analiza statistikore korrelative, mund të përfundojmë se ka lidhshmëri të negative mes përdorimit të teknologjive digjitale dhe gjinisë së nxënësve për arsye se gjinia nuk është faktorë i cili ndërlidhet me përdorimin e teknologjive digjitale. Po ashtu shohim se ka lidhshmëri të shumë të dobët pozitive mes përdorimit të teknologjive digjitale dhe moshës së nxënësve, është lidhje e dobët sepse mosha e nxënësve nuk është ndonjë faktorë i rëndësishëm i cili ndërlidhet në përdorimin e teknologjive digjitale. Gjithashtu shohim se ka lidhshmëri të negative mes përdorimit të teknologjive digjitale dhe vendbanimit të nxënësve është negative, sepse vendbanimi nuk është faktorë i cili ndikon në përdorimin e teknologjive digjitale.

Diskutime për pyetjen kërkimore: 4. A ekziston ndërlidhje mes performancës akademike dhe variablave sociodemografike: gjinia, mosha dhe vendbanimi tek nxënësit ?

Në dekadën e fundit ndikimi i teknologjisë është bërë i pashmangshëm në performancën akademike të nxënësve. Shpejtësia e përhapjes së tij e ka bërë pjesë të pandarë të jetës së nxënësve. Teknologjitë teknologjike të reja, jo vetëm që janë bërë një mjet i rëndësishëm që lidhin nxënësit me shokët e tyre (Subrahmanyam & Greenfi, 2008), por ndikimi i tyre po reflektohet në mënyrën e zhvillimit dhe të sjelljes në adoleshencë. Në fakt, Greenfi & Yan (2006) i referohen telefonit mobil si një mjet kulturor, i përbërë nga një seri e pafundme aplikacionesh. Mjediset online janë hapësira kulturore, ku normat janë krijuar në mënyrë të përbashkët dhe janë transmetuar tek përdoruesit. Kultura online nuk është statike, por është një entitet dinamiko-ciklik, dhe përdoruesit janë vazhdimisht në gjenerimin, duke kaluar në norma të reja.

Nga rezultatet e studimit tonë del se performanca akademike ka korrelacion shumë të dobët pozitiv me gjininë e nxënësve, por që kjo lidhje nuk është sinjifikative.

Performanca akademike kanë korrelacion shumë të dobët pozitiv me moshën e nxënësve, por që nuk ka lidhje sinjifikative.

Performancat akademike, kanë korrelacion shumë të dobët pozitiv me vendbanimin e nxënësve, por që nuk ka lidhje sinjifikative. Nga këto rezultate mund të përfundojmë se nuk pranojmë hipotezën e pestë.

Diskutime për pyetjen kërkimore: 5.A ekzistojnë diferenca gjinore në mënyrë statike të rëndësishme, në kontekst të varshmërisë nga teknologjitë digjitale ?

Siç citohet te Kuss (2014), roli i neurotransmeturesit dopaminë te sjellja e varur, mbështetet nga shumë studime. Në mënyrë të ngjashme, varësia nga teknologjitë digjitale ndan të njëjtin mekanizëm neurobiologjik, si varësia ndaj substancave, si pamjaftueshmëria e shpërblimeve, pasojë e mungesës së aktivitetit dopaminergjik, ndryshimeve në strukturën e trurit, e dëmtimeve në funksionet konjitive si pasojë e varësisë. Studimet theksojnë se të shfaqurit e sjelljeve varëse lidhen me disfunksionet në tru, përfshirë lobin prefrontal, kortekstin orbitofrontal dhe cingulated gyrus të cilat janë të lidhura me marrjen e vendimeve. Studimet e fundit tregojnë se ndryshime dhe aktivitete të ngjashme të trurit ndodhin në sjelljet e varësisë, përfshirë dhe varësinë ndaj internetit. Studimet mbi funksionimin e rezonancës magnetike kanë treguar se varësia ndaj teknologjive digjitale është e shoqëruar me rritjen e aktivitetit të zonave të trurit përgjegjëse më shumë për shpërblimet sesa kontrollet dhe që janë më pak të ndjeshme ndaj pasojave negative të përfshirjes në teknologjitë digjitale, përfshirë humbjen në një lojë bixhozi. Gjithashtu, studimet sugjerojnë se zona të ndryshme të trurit janë të aktivizuara te nxënësit me varësi nga teknologjitë digjitale të ngjashme me kontrollin e shëndetshëm gjatë animimit të hedhjes së topit, përfshirë talamusin, zonën paraqendrore bilaterale, zonën e mesme frontale bilaterale dhe kryqëzimin e djathtë të lobeve parentale dhe temporale, duke treguar se kështu mospersonifikimi online është i reflektuar në aktivitetin e trurit të të varurve nga teknologjitë digjitale (Pontes, 2015).

Nga rezultatet e studimit tonë, lidhur me pyetjen se a ekzistojnë diferenca gjinore në mënyrë statike të rëndësishme në kontekst të varësisë nga teknologjitë digjitale, del se femrat arrin mesatare më të lartë (2.666) se sa meshkujt (2.660). Devijimi standard për meshkujt është $Ds=0.210$ ndërsa për femrat $Ds=0.216$ dhe mesatarja e gabimit standard për gjininë mashkullore është 0.211 dhe për gjininë femërore 0.215. Nga evidenca që na jep analiza statistikore mund të përfundojmë se nuk ekzistojnë diferenca të rëndësishme gjinore në kontekstet të varësisë nga teknologjitë digjitale. Arsyeja se përse nuk na kanë dalë diferenca gjinore statistikisht të rëndësishme është sepse mostra të cilën e kemi marr ka qenë barabar

me 100 për subjektin të gjinis mashkullore dhe 100 të gjinisë femërore, andaj përgjigjet e subjekteve kanë qenë të nivelizuara.

Diskutime për pyetjen kërkimore: 6. A ekzistojnë diferenca gjinore në mënyrë statike të rëndësishme, në kontekst të pasojave performancës akademike tek nxënësit?

Është tashmë e padiskutueshme vlera e fortë arsimore e kompjuterit dhe, në të njëjtën kohë, pranohet edhe kundërshtia dhe problematika që e ndjek nga pas, të nënkuptuara nga fakti se “Interneti” – si i tillë, nuk është *as shumë i mirë* dhe *as shumë i keq*. I parë në perspektivën pedagogjike, interneti, mund të përdoret për të mirë ose për keq. Një vlerësim i tillë, gjithsesi nuk mund të jetë apriori i lehtë, sepse në përcaktimin e tij kontribuojnë shumë variabla që bashkëveprojnë në një situatë të veçantë, por le të përqendrohemi në një analizë teorike që i përket në veçanti kontekstit familjar, i cili është i karakterizuar gjithmonë nga aspekte origjinale dhe dinamika ndërpersonale gjithmonë në ndryshim. Një reflektim pedagogjik mbi këtë temë, përfshin sakaq përfitimin e një ngacmimi apo qëndrimi kërkimor dhe të kuptuarit problematik – jo gjithmonë i shpeshtë mes vetë edukatorëve – që largohet nga ndjekja e diagnozave dhe trajtimeve të lehta, nga tundimi i thjeshtimit dhe i reduktimit të problemit të matshëm, nga të dhënat empirike. Nuk duhet harruar se detyra e arsimit është që të promovojë potencialin e plotë të subjektit arsimorë dhe bashkësisë njerëzore, duke i drejtuar më së miri në drejtimet e vlerave dhe qëllimeve, në itinerarin e të qenurit dhe asaj çka duhet të jesh.

Nga rezultatet e studimit tonë shohim se femrat arrin mesatare më të ulët (1.69) se sa meshkujt (1.65). Devijimi standard për meshkujt është $Ds=0.25$ ndërsa për femrat $Ds=0.24$ dhe mesatarja e gabimit standard për gjininë mashkullore është 0.25 dhe për gjininë femërore 0.24.

Nga evidenca që na jep analiza statistikore mund të përfundojmë se nuk ekzistojnë diferenca të rëndësishme gjinore në kontekstet të performancës akademike. Arsyeja se përse nuk ekzistojnë diferenca të rëndësishme gjinore në kontekstet të performancës akademike është sepse mostra të cilën e kemi marr ka qenë barabar 100 subjekt të gjinisë mashkullore dhe 100 të gjinisë femërore andaj e përgjigjet e subjekteve kanë qenë të nivelizuara.

PËRFUNDIME

Në këtë studim është shqyrtuar literatura teorike ekzistuese duke përzgjedhur artikujt që lidhen me studimin tonë të cilat shërbejnë për të kuptuar më thellë problemin dhe për të parë lidhjen midis studimit tonë dhe studimeve të tjera të realizuara.

Nga rezultatet e studimit kemi kuptuar se nxënësit i përdorin në masë mjaft të madhe teknologjitë digjitale. Nga rezultatet kuptojmë se 82% nxënësve të anketuar e përdorin telefonin, 3% e nxënësve e përdorin ipad-in, 8% e përdorin laptopin ose kompjuterin, 7% plastalion-in dhe 1%, përdorin tjera aparate digjitale. Kurse sa i përket pyetjes këto teknologji digjitale a kanë ndërlidhje në mënyrë statike të rëndësishme, me kohën që kalojnë nxënësit në to nxjerrim këto përfundime: Varshmëria nga teknologjitë digjitale ka korrelacion shumë të dobët negativ, me kohën e kaluar në teknologjitë digjitale. Sa më tepër të kalojnë kohë nxënësit teknologjitë digjitale, aq më shumë rritet rreziku për varshmëritë nga teknologjitë digjitale. Varshmëria nga teknologjitë digjitale ka korrelacion shumë të dobët pozitiv, me performancën akademike tek nxënësit.

Nga rezultatet e studimit tonë, dalim në përfundim gjithashtu se, përdorimi i teknologjive digjitale ka korrelacion të negativ me gjininë e nxënësve, kurse ka korrelacion shumë dobët pozitive me moshën e nxënësve. Performanca akademike ka korrelacion shumë të dobët pozitiv me gjininë dhe moshën e nxënësve, por që këto lidhje nuk janë sinjifikative.

Nga rezultatet e studimit tonë lidhur me pyetjen se a ekzistojnë diferenca gjinore në mënyrë statike të rëndësishme, në kontekst të varshmërisë nga teknologjitë digjitale del se femrat arrin mesatare më të lartë (2.666) se sa meshkujt (2.660). Nga rezultatet e studimit tonë shohim se femrat arrin mesatare më të ulët (1.69) se sa meshkujt (1.65), në kontekst të performancës akademike.

REKOMANDIME

1. Organizimi i aktiviteteve ditore, duke iu dhënë rëndësi gjërave më të rëndësishme, si mësimet dhe detyrat të shkollës e pastaj qëndrimin në internet. Ndërgjegjësimi për orët e tepërta të kaluara në internet. Mbajtja e shënimeve për orën qëndrimin në internet.
2. Identifikimi i problemit. Çfarë e nxit nxënësin të qëndrojë kaq shumë në internet? Pse ata preferojnë më shumë qëndrimin në internet se sa të kalojnë kohën me miq e me shokë në jetën e përditshme?
3. Hartimi i një plani konkret për të punuar për problemin, dhe jo shmangien e tij. Sugjerohet që ky plan të përfshijë një reduktim gradual të kohës së kaluar në internet.
4. Zhvillim të veprimtarive socialo-kulturore, që do të mundësonin pjesëmarrjen e nxënësve më pranë natyrës, sportit apo kulturës duke bërë kështu që koha aktive e nxënësve të kalojë më shumë jashtë komunikimit virtual dhe më pranë atij real me shokë dhe shoqe.
5. Rritja e fushatës së ndërgjegjësimit për rreziqet që sjell një përdorim i pakontrolluar i internetit, jo vetëm në ditë të caktuara, por në mënyrë permanente, si në ambientet e shkollës, ashtu edhe në medien vizive, dhe formave të tjera të komunikimit.
6. Punonjësit socialë duhet të angazhohen në zvogëlimin e efekteve negative të shkaktuara nga bota virtuale, duke bashkëpunuar në mënyrë aktive me profesionistë të tjerë dhe prindër. Ata duhet të llojnë rreth efekteve negative të saj si dhe të kontribuojnë në ndërgjegjësimin e prindërve dhe mbarë shoqërisë për situatën e nxënësve, të cilët po enden nga një botë shoqërore “realiste” në një botë “virtuale” e cila po dikton sjelljen e tyre.
7. Punonjësit socialë, mund t’i ndihmojnë prindërit të mësojnë të përdorin programe që mund të filtrojnë përmbajtjet e dëmshme të internetit. Gjithashtu, të përdorin filtra kompjuteri për të përcaktuar se çfarë ueb-esh fëmijët e tyre vizitojnë.
8. Punonjësit socialë, mund të punojnë me prindërit për të përmirësuar performancën e tyre akademike, në lidhje me çfarë ata shohin dhe bëjnë në internet.
9. Punonjësit socialë, mund të inkurajojnë prindërit që të njohin faqet e ueb-it, që fëmijët e tyre i vizitojnë, dhe t’i monitorojnë ato sipas nevojës.
10. Punonjësit socialë, gjithashtu, mund të inkurajojnë prindërit për të diskutuar me nxënësit, për rreziqet e mundshme të cilat mund të vijnë nga interneti dhe shmangien e përdorimit të çdolloj dhune si formë ndëshkimi.

SHTOJCA

Pyetësor mbi varësinë nga teknologjitë digjitale

Mosha:_____

Gjinia:_____

Klasa:_____

Shkolla:_____

1. Cilat aparate digjitale i përdorni më shumë:

- a. Telefoni
- b. Ipad
- c. Laptop ose kompjuter
- d. Playstation
- e. Tjetër_____

2. Gjatë një dite, sa kohë kaloni në aparatet digjitale

- a. 2 orë
- b. 4 orë
- c. 6 orë
- d. 8 orë
- e. Me shumë, specifiko sa_____

3. Aparatet digjitale, i përdorni më shumë për:

- a. Rrjete sociale
- b. Filma
- c. Lojëra
- d. Për të mësuar
- c. Tjetër_____

Ju lutem vendosni X për çdo pohim në njërin nga alternativat

Nr	Pohimi	Asnjëherë	Rrallë	Ndonjëherë	Vazhdimisht	Shpesh	Gjithmonë
1	Sa shpesh ju ndodh të qëndroni pranë celularëve, ipad, laptopëve- teknologjive digjitale, më shumë se sa e kishit planifikuar.						
2	Sa shpesh ju ndodh të neglizhoni punët e përditshme, për të qëndruar më shumë pranë teknologjive digjitale.						
3	Sa shpesh ju ndodh të preferoni kënaqësinë që ju ofrojnë teknologjitë digjitale, në krahasim me kontaktet sociale në jetën e përditshme.						
4	Sa shpesh ju ndodh të krijoni miqësi me përdorues të tjerë të teknologjive digjitale.						

5	Sa shpesh personat e tjerë ankohen për sasinë e kohës që ju kaloni pranë teknologjive digjitale.						
6	Më ndodh shpesh që rezultatet e shkollës të ndikohen negativisht, për shkak të sasisë së madhe të kohës së kaluar me teknologjitë digjitale.						
7	Sa shpesh ju ndodh të kontrolloni telefonin përpara se të bëni diçka tjetër që e keni planifikuar.						
8	Sa shpesh produktiviteti juaj ulet për shkak të përdorimit të aparateve digjitale.						
9	Sa shpesh ju ndodh të vetëmbroheni kur dikush ju pyet lidhje me përdorimin e teknologjive digjitale.						
10	Sa shpesh ju ndodh të zëvendësoni mendimet shqetësuese të jetës së përditshme me mendime relaksuese të teknologjive digjitale .						
11	Sa shpesh ju ndodh të prisni me padurim për të hyrë në rrjetet sociale-						

	teknologjitë digjitale						
12	Sa shpesh mendoni që jeta pa teknologjitë digjitale do të ishte e mërzitshme, boshe dhe e trishtuar.						
13	Sa shpesh ju ndodh të nevríkoseni nëse dikush ju ndërpret kur jeni në përdorim të teknologjive digjitale						
14	Sa shpesh humbisni gjumin për shkak të qëndrimit në orët e vona në aparatet digjitale.						
15	Sa shpesh ju ndodh të keni mendjen te aparatet digjitale dhe të imagjinoni sikur i keni në dorë ato.						
16	Sa shpesh ju ndodh t'i thoni vetes “ja edhe pak minuta” kur jeni duke përdorur aparatet digjitale.						
17	Sa herë keni tentuar të kaloni më pak kohe në aparatet digjitale por nuk ia keni arritur.						
18	Sa shpesh ju ndodh të fshihni kohën e kaluar në aparatet digjitale.						
19	Sa shpesh ju ndodh të kaloni më shumë kohë në						

	aparartet digjitale se sa te dilni me të tjerët.						
20	Sa shpesh ju ndodh të ndiheni i mërzhitur kur nuk jeni pranë teknologjive digjitale, ndjenjë e cila largohet menjëherë sapo hyni në to.						

Pyetësi për performancë akademike të nxënësve

	Plotësisht nuk pajtohem	Nuk pajtohem	As pajtohem as nuk pajtohem	Pajtohem	Plotësisht pajtohem
Është e lehtë për mua të përqendrohem në leximet e caktuara (nga profesorët)	1	2	3	4	5
Nuk kam durim t'i lexoj librat mësimore	1	2	3	4	5
Shpërqendrohem shumë lehtë kur jam duke lexuar detyrat e caktuara në klasë.	1	2	3	4	5
Rrallëherë i bëj detyrat e shtëpisë .	1	2	3	4	5
	1	2	3	4	5

Tani për tani, jam tip që harxhoj kohën kot, por kjo nuk do të thotë që nuk mund	1	2	3	4	5
--	---	---	---	---	---

të bëj asgjë për ta ndryshuar këtë.					
I premtoj vetës që do të bëjë diçka, dhe pastaj përtoj.	1	2	3	4	5
Jam person që harxhon kohën kot dhe kjo s'ka shërim.	1	2	3	4	5
Mbes duke u marr me gjëra neutrale edhe pse e di që duhet nisur nga gjërat që janë të rëndësishme.	1	2	3	4	5
Kur kam një afat të caktuar, pres deri në minutën e fundit.	1	2	3	4	5
Pa arsye e shtyj përfundimin e një detyre, edhe kur ato janë të rëndësishme.	1	2	3	4	5
Te ishte një punë për nesër nuk është mënyra e duhur për ta bërë sot atë.	1	2	3	4	5
Edhe nëse e urrej veten për faktin që nuk kam filluar akoma, prapë nuk me bind të filloj.	1	2	3	4	5

Kam filluar të lë tentimet për të përmirësuar zakonet e mia të mësimet.	1	2	3	4	5
Unë ia arrijë disa të arsyetohem, pse nuk kam bërë diçka.	1	2	3	4	5

REFERENCAT

- (Ed.), *Encyclopedia of neuroscience* (pp. 1015–1022). Oxford: Academic Press.
- Arnett, J. J. (2004). *Adolescence and emerging adulthood: A cultural approach* (2nd ed.). Upper Saddle River, NJ: Pearson Prentice Hall.
- Bandura, A., Ross, D., & Ross, S. A. (1961). Transmission of aggression through imitation of aggressive models. *The Journal of Abnormal and Social Psychology*, 63, 575–582.
- Beard, K. W., & Wolf, E. M. (2001). Modification in the proposed diagnostic criteria for Internet addiction. *CyberPsychology and Behavior*, 4, 377–383.
- Berkman Center for Internet & Society at Harvard University, (2012). Teen and Technology.
- Brown, B. B. (2004). Adolescents' relationships with peers. In M. R. Lerner & L. Steinberg (Eds.), *Handbook of adolescent psychology* (2nd ed.). Hoboken, NJ: Wiley.
- Carskadon, M. A., Vieira, C., & Acebo, C. (1993). Association between puberty and delayed phase preference. *Sleep*, 16, 258–262.
- Child Wise Annual Report, (2009/2010). Protecting Children's Futures
- Coleman, J., & Hagell, A., (2007) Adolescence, Risk and Resilience: *Against the Odds, Wiley Series for Understanding Adolescence*
- Dominick, R. Joseph., (2010) Dinamikat e Komunikimit Masiv. Media në Periudhën Digjitale (12 Shkenca Sociale). UET/PRESS
- Dragoti. E., (2011) Adoleshenti . Shtypshkronja “Dajti 2000”
- Eastin, M. S., Greenberg, B. S., & Hofschire, L. (2006). Parenting the Internet. *Journal of Communication*, 56, 486–504.
- Erikson, E. H. (1968). *Identity: Youth and Crisis*. New York, NY: W W Norton & Company.
- Fine, A. G., (2004) Adolescence as Cultural Toolkit: High School Debate and the Repertoires of Childhood and Adulthood, *The Sociological Quarterly* Vol. 45/No1/2004
- Flich, Patrice (1995) Dynamics of Modern Communication The Shaping and impact of New Communication Technologies. London: Sage.

- Gross, E. F. (2004). Adolescent internet use: What we expect, what teens report. *Journal of Applied Developmental Psychology*, 25, 633–649.
- Haxhiymeri, Edlira., (2011) Sjellja Njerëzore dhe Mjedisi Social 2 (*Adoleshenca dhe Rinia*). Shtëpia botuese “Dajti 2000”
- Jashari, H. (2015). *Sociologjia e arsimit*. Shkup: Interlingua.
- Johnson, G. M., & Kupla, A. (2007). Dimensions of online behavior: Toward a user typology. *CyberPsychology and Behavior*, 10, 773-780.
- Joins, N. A., (2001). Self-disclosure in computer-mediated communication: The role of self-awareness and visual anonymity. *European Journal of Social Psychology* Volume 31, Issue 2, pages 177–192,
- Karaj, Theodori., (2004). Psikologjia e Zhvillimit të Fëmijës. Shtëpia botuese PROGRES.
- Katz, E., Gurevitch, M., & Haas, H. (1973). On the use of the mass media for important things. *American Sociological Review*, 38, 164-181.
- Lee, S. J., & Chae, Y. G. (2007). Children’s Internet use in a family context: Influence on family relationships and parental mediation. *CyberPsychology and Behavior*, 10, 640-644.
- Lekaj, P. (2018). *Varësia nga interneti*. Prishtinë: Dugagjini
- Nie, N., Hillygus, D., & Erbring, L. (2002). Internet use, interpersonal relations, and sociability. In B. Wellman & C. Haythornthwaite (Eds.), *The Internet in everyday*
- Norris. P., (2001) *Digital Divide? Civic Engagement, Information Poverty and the Internet Worldwide*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Peter, J., Valkenburg, P., & Schouten, A. (2005). Developing a model of adolescent friendship formation on the Internet. *CyberPsychology & Behavior*, 8, 423- 430
- Pew (2011) Generations 2011, Pew Internet Surveys
- Pew Internet & American Life Project. (2005). *Internet: The mainstreaming of online life*. Washington, DC: Author. Retrieved July 1, 2006, from http://www.pewinternet.org/pdfs/Internet_Status_2005.pdf.
- Rubin, A.M. (1994). Media uses and effects: A uses and gratifications perspective, in J Bryant and D. Zillmann (eds.), *Media effects: Advances in theory and research*, Hillsdale, NJ: Lawrence Erlbaum Associates, pp.417-436.

- Ryan, A. M. (2001). The peer group as a context for the development of young adolescent motivation and achievement. *Child Development*, 72, 1135–1150. Tarokh, L., & Carskadon, M. A. (2008). Sleep in adolescents. In L. R. Squire
- Tynes, B. M., Reynolds, L., & Greenfield, P. M. (2004). Adolescence, race, and ethnicity on theInternet: A comparison of discourse in monitored vs. unmonitored chat rooms. *Journal of Applied Developmental Psychology*, 25, 667–684.
- Widyanto, L., & Griffiths, M. (2007). Internet addiction: Does it really exist?(Revisited). In J. Gackenbach (Eds.), *Psychology and the Internet: Intrapersonal,interpersonal, and transpersonal implications* (2nd ed., pp. 141–163). San Diego,CA: Academic Press.
- World Internet Project, International Report, fourth edition (www.worldinterproject.net).
- Zhabaj, A. (2014). *Varësia nga interneti dhe impakti i saj në perfromancën shkollore të nxënësve*. Tiranë